



STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:
MJETET JURIDIKE NË BAZË TË LIGJIT TË
PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË

KANDIDATI:
Artan Memishi

MENTORI:
Prof.dr Besa Arifi

Tetovë, shtator, 2018

Treguesi i shkurtesave

LPP – *Ligji i procedurës penale i Republikës së Maqedonisë*

KRM – *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë*

KPRM – *Kodi penal i Republikës së Maqedonisë*

LESP – *Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale i Republikës së Maqedonisë*

KEDNJ – *Konventa Europiane për të drejtat e njeriut, 1950.*

KPPRK – *Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës*

KPPSH – *Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë*

PTHP - *Prokuroria Themelore Publike*

KSHZ – *Komisioni Shtetëror Zgjedhor*

BE- *Bashkimi European*

HYRJE

Gjyqësia është një ndër shtyllat kryesore të një shteti, është pikërisht pushteti gjyqësor që duhet të udhëheqë me drejtësi. Parimet në të cilat duhet të mbështetet pushteti gjyqësor janë pavarësia e gjykatave në marrjen e vendimeve, paanshmëria e gjykatës si dhe barazia e palëve respektivisht mënjanimi i çdo lloj forme të diskriminimit. Edhe Republika e Maqedonisë si shtet i cili aspirojnë të bëhet anëtar i BE-së duhet ti përmbush kushtet të cilat janë të parapara lidhur me gjyqësinë. Vërejtjet e tyre më së shumti shprehen lidhur me pavarësinë e gjyqësorit, influencën politike në gjyqësor, ndikimi i ekzekutivit te pushteti gjyqësor dhe presioni që u bëhet gjykatësve në marrjen e vendimeve. Janë pikërisht këto disa nga vërejtjet e tyre. Mjetet juridike na paraqiten si e drejtë me të cilën mund të atakohen vendimet gjyqësore, me anë të mjeteve juridike tentohet të përmissohet çdo gabim eventual që është bërë në procedurë, me anë të tyre shihet nëse ka shkelje procedurale, shkelje të lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe shkelje të tjera. Në këtë punim do t'i shqyrtojmë të gjitha mjetet juridike që i parasheh LPP i RM-së si dhe do të bëhet krahasimi i tyre me vendet e rajonit, gjithashtu edhe analizimi i rasteve konkrete.

PËRMBAJTJA

Treguesi i shkurtesave.....	II
Hyrje.....	III

KAPITULLI I I

1. Historiku i mjeteve juridike.....	1
1.1. Vështrimi i përgjithshëm i mjeteve juridike.....	1
1.2. Funkcioni i mjeteve juridike.....	2

KAPITULLI I II

2. Mjetet e rregullta juridike në bazë të LPP të RM-së.....	4
2.1 Ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë.....	4
2.1.1. Subjektet të cilat mund të parashtrijnë ankesë.....	4
2.1.2. Përmbajtja e ankesës.....	5
2.1.3. Baza për ankesë.....	5
2.1.3.1. Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.....	5
2.1.3.2. Shkeljet të Kodit Penal	7
2.1.3.3. Vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike.....	7
2.1.3.4. Vendimit për sanksione ndëshkuese, për konfiskimin e përfitimit pronësor, për shëpnzimet e procedurës penale, për kërkesat pronësore juridike, si dhe për shkak të vendimit për shpalljen e aktgjykimit nëpërmjet shtypit, radios ose televizionit.....	8
2.1.4. Procedura sipas ankesës.....	8
2.1.4.1. Procedura me ankesë në gjykatën e shkallës së parë.....	8
2.1.5. Procedura me ankesë në gjykatën e shkallës së dytë.....	8
2.1.5.1. Kufijt e shqyrtimit të aktgjykimit të shkallës së parë.....	10

2.1.5.2. Vendimet e gjykatës së shkallës së dytë.....	10
2.1.6. Reformatio in peius dhe beneficium cohaesionis.....	11
2.2. Ankesa ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.....	12
2.3. Ankesa ndaj aktvendimit	13

KAPITULLI I III

3. Mjetet e jashtëzakonshme juridike në bazë të LPP të RM-së.....	15
3.1. Rishikimi i procedurës penale.....	16
3.1.1. Ndryshimi i aktgjykimit të plotëfuqishëm pa përsëritjen e procedurës.....	16
3.1.2. Vazhdimi i procedurës penale.....	17
3.1.3. Përsëritja e procedurës në interes të të dënuarit.....	18
3.1.4. Personat e autorizuar që të parashtrojnë kërkesë për përsëritje të procedurës.....	19
3.1.5. Gjykata e cila vendos për kërkesën dhe përmbajtja e kërkesës.....	19
3.1.6. Vendosja për kërkesën për përsëritje të procedurës penale.....	19
3.1.7. Leja për përsëritjen e procedurës ose refuzimi i kërkesës për përsëritjen e procedurës.....	20
3.1.8. Rregullat për procedurën e re.....	20
3.1.9. Përsëritja e procedurës së personit të dënuar në mungesë.....	20
3.2. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.....	22
3.2.1. Subjektet dhe afatet.....	22
3.2.2. Vendosja për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.....	23
3.2.3. Vendimet e Gjykatës Supreme.....	23
3.3 Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm.....	24
3.3.1 Bazat për paraqitjen e kërkesës.....	25
3.3.2 Subjektet që mund të paraqesin kërkesë.....	25
3.3.3 Vendosja për kërkesën.....	25

KAPITULLI I IV

4. Krahاسimi i mjeteve juridike.....	26
4.1. Mjetet juridike ne bazë te Kodit të Procedurës Penale te Republikës së Kosovës.....	26
4.1.1. Ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit.....	26
4.1.2. Ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme të Kosovës.....	28
4.1.3. Ankesa kundër aktvendimit.....	28
4.1.4. Mjetet e jashtëzakonshme juridike.....	29
4.1.4.1 Rishikimi i procedurës penale.....	30
4.1.4.2 Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit.....	31
4.1.4.3 Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.....	32
4.1.5 Krahاسimi i procedurës lidhur me mjetet juridike Maqedoni-Kosovë.....	33
4.2. Mjetet juridike në bazë të Kodi të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.....	34
4.2.1 Apeli	35
4.2.2 Rekursi në Gjykatën e Lartë.....	36
4.2.3 Rishikimi	38
4.2.4 Krahاسimi i procedurës lidhur me mjetet juridike Maqedoni-Shqipëri.....	40

KAPITULLI I V

5. Analizimi i rasteve konkrete	41
5.1. Ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë.....	41
5.2. Ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së dytë.....	45
5.3. Ankesa ndaj aktvendimit.....	49
5.4. Përsëritja e procedurës penale.....	51
5.5. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.....	54
5.6. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm.....	58
PËRFUNDIME.....	61
LITERATURË E SHFRYTËZUAR.....	62

Kapitulli i I

1. Historiku i mjeteve juridike

Mjetet juridike kanë lindur që në mesjetë, në periudhën e perandorisë, kur gjyqtarët u bënë nëpunës të aparatit shtetëror. Ai bazohej në të drejtën e perandorit për të ndërhyrë në veprimet e nëpunësve të tij. Lutja që i drejtohej perandroit për të ndërhyrë në veprimet e nëpunësve të varur prej tij, quhej “**apellatio**”. Domethenë apel, që kishte kuptimin e të drejtuarit diku me fjalë për të goditur vendimin e një gjyqtari më të ulët përpara gjyqtarëve më të lartë.¹

Vetëm pas Revolucionit Francez u pranua **parimi procedural i gjykimit në dy shkallë**, i bazuar jo në varësinë e gjyqtarit më të ulët nga ai më i lartë, sepse gjyqtarët varen vetëm nga ligji.²

1.1 Vështrimi i përgjithshëm i mjeteve juridike

E drejta e ankimit parashihet edhe në nenin 2, të protokollit të shtatë në **Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut**, në paragrafin e parë të këtij neni thuhet: “ Çdo person i deklaruar fajtor për një vepër penale, ka të drejtë të paraqesë ankesë përpara një gjykate më të lartë. Ushtrimi i kësaj të drejte, përfshirë edhe shkaqet për të cilat ajo ushtrohet, janë të përcaktuara me ligj”³

KEDNJ nga viti 1950 përmban shumë të drejta nga fusha e të drejtave të njeriut, në veçanti dispozitat për mbrojtjen nga paraburgimi hetues, e drejta e procedurës fer dhe në afat të arsyeshëm, prezumcioni i pafajësisë, kërkesa për marrjen e informative në gjuhën amtare, prezenca e përkthyesit pa kompensim në të holla dhe e drejta e të pasurit kohë të mjaftueshme në përgatitjen e mbrojtjes.⁴

Në paragrafin e dytë të këtij neni thuhet se: “ Kjo e drejtë mundet të kufizohet për vepra më të lehta, siç janë të përcaktuara me ligj ose kur personi është gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë.”⁵

Nga ky nen mundet të kuptojmë se vendet mundet edhe të kufizojnë të drejtën e ankesës për vepra veçanërisht të lehta, si vepra të tilla mundet të jenë kundërvajtjet ose gjoba. LPP i RM-së nuk e kufizon të drejtën e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa e drejta e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë mundet edhe të kufizohet, ligji i paraseh në mënyrë decide se cilat janë ato raste, në vijim të punimit do ti shqyrtojmë të gjitha raste në të cilat mundet të kufizohet e drejta e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Edhe pse gjykatat në procedurë penale udhëhiqen nga parimi i **ligjshmërisë** si parim bazë i procedurës

¹ ISLAMI, Halim. HOXHA, Artan. PANDA, Iir. Procedura Penale, Tiranë. 2003, fq. 525

² Po aty, fq. 525

³ Neni 2, paragrafi 1, Protokollit i shtatë, Konventa Evropiane për liritë dhe të drejtat e njeriut

⁴ Shreder, Fridrih-Kristijan, E drejta e procedurës penale. ALAMINA, Shkup, 2011, fq.222

⁵ Neni 2, paragrafi 2, Protokollit i shtatë, Konventa Evropiane për liritë dhe të drejtat e njeriut

penale, kjo nuk don të thotë që në çdo vendim gjyqësor arrihet e vërteta dhe bëhet vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, pra ekziston mundësia që një vendim gjyqësor i gjykatës së shkallës së parë të mos jetë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore ose të mos jetë i drejtë. Është e patolerueshme që të ekzekutohet një vendim gjyqësor i cili është i padrejtë, i cili është në kundërshtim me dispozitat ligjore, çdo vend demokratik duhet të synojë që vendimet që merren në gjykata e vendit përkatës të jenë të drejta, në përpikmëri të zbatohet çdo normë ligjore dhe gjykata të gjykojë në mënyrë të paanshme.

Me qëllim që të pengohet marrja e vendimeve të padrejta dhe kundërligjore janë të parapara mjetet juridike, me anë të tyre personat e autorizuar kundërshtojnë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, që i jep mundësi gjykatës së shkallës së dytë që të përmisojë çdo gabim eventual apo shkelje të dispozitave ligjore, në LPP janë të paraparë personat e autorizuar të cilët mund të paraqesin ankesë si dhe rastet për të cilat paraqitet.

Teoria e së drejtës penale dhe e procedurës penale mjetet juridike i trajton si veprime procedurale me të cilat personat e autorizuar e ankimojnë vendimin e sjellur në procedurë penale dhe kërkojnë që ai vendim të anulohet ose të përmisohet në një vendim të ri. Pasoja e përdorimit të mjeteve juridike është se vendimi i ankimuar duhet të jetë subjekt i rishikimit dhe të anulohet ose të përmisohet nëse është i gabuar.⁶

1.2 Funksioni i mjeteve juridike

E drejta e ankesës është e drejtë e cila garantohet edhe me **Kushtetutën e RM-së, neni 15 i Kushtetutës së RM-së** thot: ‘Garantohet e drejta e ankesës kundër akteve të veçanta juridike, të miratuara në procedurën e shkallës së parë para gjykatës, para organit administrative apo organizatës ose institucioneve të tjera që kryejnë autorizime publike’⁷

Funksioni bazë i mjeteve juridike është në atë që të jepet mundësia që të arrihet një vendim i drejtë dhe i ligjshëm. Vendimi gjyqësor është më bindës kur një çështje penale shqyrtohet në më shumë instanca. Nëse palët mendojnë se aktgjykimi apo procedura me të cilën është sjellë aktgjykimi i tillë është jo e drejtë dhe kundërligjore, do të shfrytëzojnë mjetin juridik me të cilin do të kërkojnë nga shkalla më e lartë që ta përmisojë aktgjykimin jo të drejtë, respektivisht kundërligjor. Procedura me mjetet juridike nuk është procedurë e detyrueshme, ajo është në dispozicion të palëve si e drejte, dho jo si detyrim.

Disa nga funksionet e mjeteve juridike janë:

- **Dyshkallshmëria dhe treshkallshmëria e procedurës penale** – si përparësi të procedurës penale e cila është dyshkallëshe paraqiten: efikasiteti në luftën kundër kriminalitetit si fenomen shoqëror, ku përveç tjerash varet edhe nga shpejtësia e verpimit dhe për këtë arsye mednohet se procedura penale

⁶ Матовски, Никола. Лажетик-Бужаровска, Гордана. Калајџиев, Гордан. Казнено Процесно Право, Скопје, 2011, fq.336

⁷ Neni 15, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

është më mirë të jetë dyshkallëshe. Procedura jonë penale në parim është dyshkallëshe, por në disa raste është edhe treshkallëshe për shkak se ekziston mjet juridik kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.⁸

- ***Dhënia e mundësisë për një vendim të ligjshëm*** – te vendimi gjyqësor i cili kalon nëpër disa instanca gjyqësore ekziston mundësi më e vogël që ai vendim të mos jetë i drejtë dhe jo i ligjshëm. Edhe përkaj të përgatitjes profesionale që kanë gjykatësit e gjykatave të shkallës së parë, ekziston mundësia që të ketë gabime në vendimin e marrë siç janë gabimet procedurale apo gabimet lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike.⁹

Në procedurën penale të RM-së mjetet juridike ndahen në mjete juridike të rregullta dhe mjete juridike të jashtëzakonshme.

Mjetet e rregullta juridike mund të paraqiten në të gjitha rethanat dhe nga të gjitha palët dhe me to mund të sinjalizohen lëndimet sipas të gjitha bazave, faktike dhe juridike. Ndërsa mjetet juridike të jashtëzakonshme, përdoren përjashtimisht, vetëm në rastet e përcaktuara me ligj dhe për shkaqe të caktuara.¹⁰

Në bazë të LPP të RM-së si mjete të rregullta juridike janë:

- 1) **Ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë¹¹**
- 2) **Ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë¹²**
- 3) **Ankesa ndaj aktvendimit¹³**

Mjete juridike të jashtëzakonshme janë:

- 1) **Përsëritja e procedurës penale¹⁴**
- 2) **Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë¹⁵**
- 3) **Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm¹⁶**

⁸ Матовски, Никола. Лажетик-Бужаровска, Гордана. Калајџиев, Гордан. Казнено Процесно Право, Скопје, 2011, fq.338

⁹ Po aty, fq.337

¹⁰ Sahiti, Ejup. Zejneli, Ismail. Edrejta e Procedurës Penale e RM-së, Shkup, 2017. Fq. 274

¹¹ Neni 410, Ligji i Procedurës penale i RM-së

¹² Po aty, neni 439

¹³ Po aty, neni 440

¹⁴ Po aty, neni 446

¹⁵ Po aty, neni 457

¹⁶ Po aty, neni 463

Kapitulli i II

2. Mjetet e rregullta juridike në bazë të LPP të RM-së

2.1 Ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë

Pas përfundimit të gjykimit në shkallë të parë, procedura penale mund të vazhdohet edhe në shkallë të dytë, vetëm në bazë të iniciativës së personit të autorizuar.¹⁷ Personat e autorizuar për të paraqitur ankesë, kanë të drejte për të paraqitur ankesë në afat prej 15 ditësh nda dita e marrjes së aktgjykimit. Ky është i vetmi mjet i rregullt juridik ku mund të ankimohen edhe gabimet e natyrës faktike (*error facti*) poashtu edhe gabimet e natyrës juridike (*error iuris*).

2.1.1 Subjektet të cilat mund të parashtrojnë ankesë

Në bazë të nenit 411 të LPP-së, ankesë mund të parashtrojnë palët, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit dhe i dëmtuari.

Në interes të të akuzuarit ankesë mund të parashtrojnë bashkëshorti, respektivisht bashkëshorti jashtëmartesor, të afërmit e gjakut në vijë të drejtë, adaptuesi, i adaptuari, vëllau, motra dhe mbajtësi. Afati për ankesë në këtë rast rrjedh nga dita kur të akuzuarit, përkatësisht mbrojtësit të tijë i është dorëzuar kopja e aktgjykimit.

Prokurori publik mund të parashtrojë ankesë si në dëm ashtu edhe në dobi të të akuzuarit.

Ankesë mund të parashtrojë edhe personi sendi i të cilit është marrë ose nga i cili është konfiskuar prona ose interesi pronësor i fituar me vepër penale, si dhe personit juridik të cilit i është shqiptuar masa-konfiskim i dobisë pasurore.

I akuzuari mund të heq dorë nga e drejta e ankesës vetëm pas marrjes së aktgjykimit. I akuzuari edhe para kësaj mund të heq dorë nga e drejta e ankesës, nëse paditësi dhe i dëmtuari kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në të gjitha bazat, përjashtimisht kur i akuzuari në bazë të aktgjykimit duhet të vuaj dënimin me burgim.

Paditësi dhe i dëmtuari mundet të heqin dorë nga e drejta e ankesës prej momentit të shpalljes së aktgjykimit deri në skadimin e afatit për parashtrim të ankesës, por mundet deri në sjelljen e vendimit në shkallë të dytë për ankesën tashmë të parashtruar. Tërheqja dhe heqja dorë nga ankesa nuk mundet të revokohen.

¹⁷ Sahiti, Ejup. Zejneli, Ismail. Edrejta e Procedurës Penale e RM-së, Shkup, 2017. Fq. 275

2.1.2 Përmbajtja e ankesës

Në bazë të nenit 413, paragrafi 1, ankesa duhet t'i përmbajë elementet vijuese:

- Shënimin e aktgjykimit kundër të cilit parashtrohet ankesa
- Bazën për paraqitjen e ankesës
- Arsyetimin e ankesës
- Propozimin për prishje të tërësishëm ose të pjesërisht të aktgjykimit ose ndryshim të tij
- Nënshkrimin e personit i cili paraqet ankesë

2.1.3 Baza për ankesë

E drejta e procedurës penale e RM-së, arsyet për të cilat mund të parashtrohet ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, në shkallë të dytë, i sistematizon në katër grupe:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale
- Të shkeljes së Kodit Penal
- Të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike
- Vendimit për sanksione ndëshkuese, për konfiskimin e përfitimit pronësor, për shëpnzimet e procedurës penale, për kërkesat pronësore juridike, si dhe për shkak të vendimit për shpalljen e katgjykimit nëpërmjet shtypit, radios ose televizionit

2.1.3.1 Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

Të gjitha shkeljet e dispozitave të procedurës penale të cilat mund t'i bëj gjykata e shkallës së parë dhe që paraqiten si bazë për ankesë në shkallë të dytë, ndahen në shkelje **absolute** dhe **relative**.¹⁸

Sipas nenit 415, paragrafi 1, të LPP-së, **shkeljet absolute** të procedurës penale janë:

1. **Gjykata ka qenë e përbërë në mënyrë të parregullt, ose kur me rastin e marrjes së aktgjykimit ka marr pjesë gjykatësi ose gjykatësi porot i cili nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin kryesor ose me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi.** Përbërja jo e rregullt e gjykatës ekziston kur përbërja e kolegjit i cili e ka proceduar dhe ka marrë vendim nuk i përgjigjet dispozitave të LPP-së dhe rregullave të gjykatës.
2. **Në shqyrtim ka marrë pjesë gjykatësi ose gjykatësi porot i cili patjetër është dashur të përjashtohet.** Kjo shkelje ndodh kur ekziston ndonjëra nga bazat që kërkon përjashtim të patjetërsueshëm të gjykatësit ose gjykatësit porot.

¹⁸ Po aty, fq.278

3. Shqyrtimi kryesor është mbajtur pa personin prania e të cilit në shqyrtimin kryesor është e detyrueshme sipas ligjit;
4. Në kundërshtim me ligjin, publiku ka qenë i përjashtuar në shqyrtimin kryesor;
5. Gjykata ka shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me çështjen a ekziston akuzë nga paditësi i autorizuar ose propozim nga i dëmtuari, përkatësisht leje nga organi kompetent;
6. Aktgjykimin e ka sjellë gjykata e cila sipas kompetencës reale nuk ka mundur të gjykojë në atë lëndë ose nëse gjykata në mënyrë të parregullt e ka refuzuar akuzën për shkak të **jokompetencës reale**. Gjykata është e detyruar *ex officio* të kujdeset për kompetencën reale, nëse vërtetohet se gjykata nuk ka kompetencë reale, është e detyruar të shpallet si jokompetente, dhe lëndën të ja dorëzoj gjykatës me kompetencë reale.¹⁹
7. Gjykata me aktgjykim nuk e ka zgjidhur plotësisht lëndën e akuzës. Kjo shkelje ekziston kur gjykata nuk vendos për të gjitha veprat penale që janë në aktakuzë.
8. Aktgjykimi mbështetet në dëshmi në të cilat nuk mund të bazohet aktgjykimi, përveç se nëse duke pasur parasysh provat e tjera është e qartë se edhe pa atë provë do të ishte miratuar aktgjykim i njëjtë. LPP e ndalon që kundër të akuzuarit të përdoret dhunë, kërcënim ose mjete të ngjashme, si përsëmbull, intervenime mjekësore me të cilat mund të ndikohet në vullnetin e tij për të dhënë deklaratë. Dhe nëse kundër të akuzuarit janë përdorur këto mjete, aktgjykimi nuk mund të bazohet në deklaratën e të akuzuarit.²⁰
9. Aktakuza është tejkaluar
10. Me aktgjykim është shkelur dispozita e ndalimit për ndryshim në të keq (*reformatio in peius*);
11. Aktgjykimi është i paqartë dhe kundërthënës në vete ose në të nuk janë përmendur faktet ose provat vendimtare të nxjerra në shqyrtim kryesor;
12. Shkelen dispozitat procedurale që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës. Nëse i akuzuari nuk e kupton gjuhën në të cilën udhëhiqet procedura kundër tij, atëher ai ka të drejtën e përkthyesit, mungesa e përkthyesit në procedurë paraqet shkelje absolute përshkak së i akuzuari nuk mund të kuptojë akuzën që është ngritur kundër tij dhe nuk mundet të marrë pjesë aktivisht në proces.²¹

Shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së ekzistojnë kur gjykata deri sa e ka përgatitur shqyrtimin kryesor, gjatë shqyrtimit kryesor, ose gjatë marrjes së aktgjykimit, nuk e ka zbatuar ose e ka zbatuar në mënyrë jo të rregullt ndonjë dispozitë të LPP, dhe se kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në rregullsinë

¹⁹ Матовски, Никола. Лажетик-Бужаровска, Гордана. Калаџиџев, Гордан. Казнено Процесно Право, Скопје, 2011, fq.345

²⁰ Po aty, fq.346

²¹ Po aty, fq.347

dhe ligjshmërinë e marrjes së aktgjykimit. Shkelje esenciale ekzistojnë edhe nëse është shkelur e drejta e mbrojtjes dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e aktgjykimit ose të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë.

2.1.3.2 Shkeljet e Kodit penal (*error in iudicando*)

Shkeljet e Kodit penal ekzistojnë kur gjykata e ka zbatuar gabimisht ndonjë dispozitë të Kodit penal ose nuk e zbatuar fare dispozitën konkrete. Shkeljet e Kodit penal, të cilat mundet të jenë bazë për paraqitjen e ankesës janë të parapara në nenin 416 të LPP-së, edhe atë:

- 1. Vepra për të cilën ndiqet i akuzuari nuk është vepër penale;**
- 2. Ekzistojnë rethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale;**
- 3. Ekzistojnë rethana që e përjashtojnë ndjekejn penale, e veçanërisht nëse ndjekja penale është parashkruar ose ndjekja është përjashtuar për shkak të amnistisë ose faljes, ose më parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë;**
- 4. Lidhur me veprën penale që është objekt i akuzës është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet;**
- 5. Në marrjen e vendimit për dënim, për dënim me kusht ose vërejtje gjyqësore, për masën e sigurisë ose për konfiskimin e dobisë pronësore, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore;**
- 6. Janë shkelur dispozitat për llogaritjen e paraburgimit apo çarëdo kufizimi të lirisë dhe të dënimit të mbajtur;**

2.1.3.3 Vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike

Vërtetimi i gabueshëm i gjendjes faktike ekziston kur gjykata ndonjë fakt vendimtar e ka vërtetuar gabimisht ose nuk e ka vërtetuar fare. Vërtetimi i gabueshëm i gjendjes faktike paraqet bazë për goditjen me ankesë të aktgjykimit të shkallës së parë, të cilën gjykata e shkallës së dytë mundet ta kthejë për rigjykim. Vërtetimi i gabueshëm i gjendjes faktike ekziston kur gjykata në procedurë për vërtetimin e fakteve, do i mër në shqyrtim të gjitha faktet relevante, dhe i merr të gjitha provat që i ka në disponim për vërtetimin e atyre fakteve, por pastaj gabimisht i vlerëson provat e marura dhe vjen në përfundim të gabueshëm.²²

Vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ekziston kur gjykata e shkallës së parë ka bërë lëshime me rastin e vërtetimit të ndonjë fakti vendimtar ose nuk i ka prezentuar të gjitha provat e rëndësishme të cilat kanë mundur të ndikojnë në vendimin përfundimtar.

²² Po aty, fq.349

2.1.3.4 Vendimit për sanksione ndëshkuese, për konfiskimin e përfitimit pronësor, për shepnzimet e procedurës penale, për kërkesat pronësore juridike, si dhe për shkak të vendimit për shpalljen e aktgjykimit nëpërmjet shtypit, radios ose televizionit

Aktgjykimi mund të atakohet për shkak të vendimit për dënim, dënim me kusht dhe vërejtje gjyqësore, kur me këtë vendim nuk është tejkaluar autorizimi ligjor, por gjykata nuk e ka caktuar drejt dënimit ose nuk i ka zbatuar dispozitat ligjore për lehtësimin e dënimit, për lirim nga dënimi, për dënim me kusht ose për vërejtje gjyqësore, edhe pse për këtë kanë ekzistuar kushtet ligjore.

Vendimi për shpalljen e aktgjykimit nëpërmjet shtypit, radios ose televizionit, mund të ankimohet kur gjykata për këto çështje ka miratuar vendim në kundërshtim me dispozitat ligjore.

2.1.4 Procedura sipas ankesës

Procedura sipas ankesës zhvillohet në dy pjesë: procedura para gjykatës së shkallës së parë dhe procedura para gjykatës së shkallës së dytë.

2.1.4.1 Procedura me ankesë në gjykatën e shkallës së parë

Ankesa i paraqitet gjykatës e cila e ka kumtuar aktgjykimin që nënkupton në gjykatën e shkallës së parë për gjykatën e shkallës së dytë, me numër të mjaftueshëm të kopjeve për gjykatën, si dhe për palën kundërshtare dhe mbrojtësin. Ankesa e cila nuk paraqitet në kohë do të hedhet poshtë me aktvendim nga kryetari i trupit gjykues.²³ Një ekzemplar të ankesës gjykata ia dorëzon edhe palës kundërshtare, e cila në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të ankesës, mundet të paraqes te trupi gjykues përgjigje ndaj ankesës. Pas kalimit të këtij afati, kryetari i trupit gjykues të gjitha shkresa dhe dokumentacionin përkatës ia dorëzon gjykatës së shkallës së dytë.

2.1.5 Procedura me ankesë në gjykatën e shkallës së dytë

Pjesa e dytë e procedurës lidhur me ankesë është procedura para gjykatës së shkallës së dytë. Pasi të arrijnë të gjitha shkresat në gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej tre ditësh nga pranimi i shkresave caktohet gjykatësi referues. Gjyqtari referues ka për detyrë të studiojë lëndën, veçanërisht parashtrimet e ankuesit. Në këtë drejtim sipas nevojës mundet të kërkojë nga gjykata e shkallës së parë raport mbi shkeljet e dispozotave të procedurës penale, ose raport nga gjykatësi i procedurës paraprake i gjykatës ku duhet të ndërmeret veprimi procedural osë në ndonjë mënyrë tjetër t'i vërtetojë pretendimet në ankesë lidhur me provat dhe faktet e reja.²⁴

²³ Neni 419, paragrafi 2, LPP i RM-së

²⁴ Sahiti, Ejup. Zejneli, Ismail. Edrejta e Procedurës Penale e RM-së, Shkup, 2017. fq. 282

Gjykata e shkallës së dytë i merr vendimet në dy mënyra: marrja e vendimit në kolegji dhe marrja e vendimit pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor. Për seancën gjyqësore informohet prokurori, i akuzuari dhe mbrojtësi, mosardhja e palëve dhe mbrojtësit të ftuar në mënyrë të rregullt, nuk e pengon mbajtjen e seancës.²⁵ Seanca e gjykatës së shkallës së dytë është publike, por publiku edhe mundet të përjashtohet në rastet e përcaktuara me ligj. Procesverbali i seancës së këshillit i bashkangjitet shkresave të gjykatës së shkallës ë parë dhe të dytë.

Debati para kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë do të mbahet nëse:

- a. Vërtetohet se ekziston shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale
- b. Vërtetohet se ekziston gjendja faktike e vërtetuar gabimisht gjatë procedurës së shkallës së parë, ose kur faktet dhe provat e reja për herë të parë të deklaruar në ankesë janë vlerësuar si të lejueshme.

Këto dy kushte janë të parapara në LPP, sepse vërtetimi i gjendjes faktike është detyrë e gjykatës së shkallës së parë, dhe pa ekzistimin e arsyeve të justifikueshme nuk duhet të mbahet shqyrtim para gjykatës së shkallës së dytë, por ku kjo është e nevojshme për vërtetimin e fakteve.

Në shqyrtim nuk mundet që të zgjerohen arsyet për paraqitjen e ankesës, as të paraqiten baza ose arsye të reja.²⁶ Shqyrtimi para gjykatës së shkallës së dytë vijon me raportimin e gjykatësit referues, i cili ekspozon gjendjen reale, pa dhënë mendim të vetin lidhur me bazueshmërinë e ankesës. Pastaj do të lexohet aktgjykimi ose vetëm një pjesë e aktgjykimit me të cilin ka të bëjë ankesa. E merr fjalën parashtruesi i ankesës i cili duhet duhet ta arsyetojë ankesën dhe t'i argumentojë bazat në të cilat e mbështet ankesën e tij, pastaj e merr fjalën pala kundërshtare që t'i përgjigjet konstatimeve të parashtruesit të ankesës. I akuzuari dhe mbrojtësi i tij çdoherë e mbajnë fjalën e fundit. Paditësi duke pasur parasysh rjedhën e seancës mundet që në tërësi ose pjesërisht të heq dorë nga akuza ose ta ndryshojë akuzën në dobi të akuzuarit. Nëse është paraqitur ankesë vetëm në interes të të akuzuarit, aktgjykimi nuk guxon të ndryshohet në dëm të tij.²⁷

²⁵ Çoliq-Sirjeçiq, Hajrija. Halilović, Haris. E drejta e Procedurës Penale Më vështrim të posaçëm në procedurën penale të Kosovës, Prishtinë, 2007, fq.200

²⁶ Матовски, Никола. Лажетик-Бужаровска, Гордана. Калаџиџев, Гордан. Казнено Процесно Право, Скопје, 2011, fq.355

²⁷ Бојлке, Вернер. Закон за кривична постапка, Датапонс, 2009, fq.357

2.1.5.1 Kufijt e shyrtymit te aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë

Procedura penale e Republikës së Maqedonisë bazohet në parimin *tantum devolutum quantum appellatum* që domethënë se gjykata e shkallës së dytë e shqyrton aktgjykimin vetëm në atë pjesë e cila goditet me ankesë, që domethënë se nuk rishqyrtohen ato pjesë të aktgjykimit të cilat nuk janë goditur me ankesë.²⁸

Megjithatë ekzistojnë raste në të cilat gjykata e shkallës së dytë në bazë të detyrës zyrtare duhet ta shqyrtojë aktgjykimin e shkallës së parë në këto baza:

- 1) Nëse ekziston shkelje të dispozitave në procedurën penale nga neni 415, paragrafi (1), pikat 1), 5), 6), 8), 9), 10) dhe 11) të LPP të RM-së, dhe nëse seanca kryesore në kundërshtim me dispozitat e LPP është mbajtur në mungesë të të akuzuarit, e në rast të mbrojtjes së detyrueshme edhe në mungesë të mbrojtësit;
- 2) Nëse në dëm të të akuzuarit është shkelur Kodi penal;

2.1.5.2 Vendimet e gjykatës së shkallës së dytë

Duke e shqyrtuar aktgjykimin e goditur me ankesë, gjykata e shkallës së dytë në seancën e kolegjit mund të merr vendimet vijuese:

- 1) **E hedh ankesën si të paafatshme ose të pa lejuar**, gjykata e merr këtë vendim kur nuk është respektuar afati për paraqitjen e ankesës, i cili afat është prekluziv, dhe pas kalimit të atij afati pala e humb të drejtën e paraqitjes së ankesës. Gjykata e hedh ankesën me **aktvendim**;
- 2) **E refuzon ankesën si të pabazë dhe vërteton aktgjykimin e shkallës së parë**, ky vendim sillet kur gjykata e shkallës së dytë do e refuzoj ankesën si të pabazë dhe do e vërtetojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, në rastet kur do të vërtetohet se nuk ekzistojnë arsyet për të cilat goditet aktgjykimi, dhe as shkelje të dispozitave ligjore për të cilat gjykata e shkallës së dytë duhet të veprojë në bazë të detyrës zyrtare. Me rastin e sjelljes së këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së dytë nuk do t'i referohet vetëm në bazueshmërinë e ankesës, por në vendimin e saj do të jap edhe mendimin dhe arsyetimin se pse aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë.²⁹
- 3) **E prish aktgjykimin dhe çështjen ja kthen gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim dhe vendim**, gjykata do e sjellë këtë vendim kur me aktvendim do e prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë,

²⁸ Матовски, Никола. Лажетик-Бужаровска, Гордана. Калаџиџев, Гордан. Казнено Процесно Право, Скопје, 2011, fq.356

²⁹ По аty, fq.359

dhe çështjen do e rikthej në rigjykim, nëse vërteton se ekzistojnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ose nëse vërteton se ka vërtetim të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe për këtë duhet të mbahet shqyrtim kryesor në shkallë të parë. Gjykata e shkallës së dytë mundet që ta prish aktgjymin edhe vetëm pjesërisht, nëse disa pjesë të aktgjykimit mund të veçohen pa dëm për gjykim të drejtë. Me rastin e marrjes së këtij vendimi, gjykata e shkallës së dytë ja kthen gjykatës së shkallës së parë të gjitha shkresat penale;

4) E ndryshon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, gjykata e shkallës së dytë duke e pranuar ankesën ose sipas detyrës zyrtare me aktgjykim do ta ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, nëse vërteton se faktet vendimtare ne aktgjykimin e shkallës së parë janë vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe se duke marrë parasysh gjendjen e vërtetuar faktike, me zbatimin e rregullt të ligjit duhet të merret aktgjykim tjetër apo i ndryshëm nga ai i shkallës së parë.

2.1.6 Reformatio in peius dhe beneficium cohaesionis

Reformatio in peius nënkupton ndalimin për ndryshimin e pozitës së të akuzuarit për më keq. Ky beneficion e siguron palën e cila përdor mjetin juridik, që të mos frikësohet se vendimi i gjykatës së shkallës së dytë do të jetë edhe më i rëndë se ai i shkallës së parë.³⁰ Me këtë mundësohet ajo se kur ankesa është paraqitur në dobi të të akuzuarit, ajo nuk mundet të shkojë edhe në dëm të tij. Në literaturë thuhet se nuk është e drejtë që aktgjykimi të ndryshohet në dëm të të akuzuarit dhe të keqësohet gjendja e tij, sepse ai ka paraqitur ankesë vetëm në dobi të tij, sepse pala kundërshtare deri sa nuk ka paraqitur mjet juridik domethënë se është e kënaqur nga vendimi i shkallës së parë. Ky beneficion të akuzuarit i jep liri në përdorimin e mjetit juridik, sepse nëse të akuzuarit i kanoset edhe mundësia që aktgjykimi të mund të ndryshojë edhe për më keq atëherë ai nuk do të jetë i lirë në përdorimin e mjetit juridik. Me këtë te akuzuarit i jepet liria e përdorimit të mjeteve juridike që është e drejtë kushtetuese e çdo qytetari i RM-së.³¹

Beneficium cohaesionis është një beneficion të cilin e hasim në procedurë penale. Me këtë beneficion nënkuptojmë se gjykata është e detyruar që, përshtatshmëritë për të cilat ka konstatuar se ekzistojnë për të akuzuarin, i cili e ka paraqitur mjetin juridik, ta zbatojë edhe ndaj të akuzuarve të tjerë, pa marrë parasysh se a kanë paraqitur mjet juridik ne atë drejtim ose jo.³²

³⁰ Фолк, Клаус, Казнено-процесно право-Основен курс, ALAMINA, Скопје, 2013, fq.303

³¹ Матовски, Никола. Лажетик-Бужаровска, Гордана. Калајџиев, Гордан. Казнено Процесно Право, Скопје, 2011, fq.360

³² Sahiti, Ejup. Zejneli, Ismail. Edrejta e Procedurës Penale e RM-së, Shkup, 2017. fq. 287

2.2 Ankesa ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë

E drejta e ankesës është e drejtë e cila garantohet edhe me kushtetutën e RM-së, kundër aktgjykimit të shkallës së parë lejohet ankesa në shkallë të dytë, dhe se me marrjen e vendimit në shkallë të dytë, çështja konsiderohet si e gjykuar. Por LPP i RM-së parasheh disa raste në të cilat përveç goditjes së aktgjykimit të shkallës së parë, mund të ankimohet edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë. LPP i parasheh në mënyrë taksative rastet në të cilat mundet të paraqitet ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Sipas nenit 439 të LPP-se, ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë mund të paraqitet:

- 1) Nëse gjykata e shkallës së dytë ka shqiptuar dënim me burgim të përjetshëm, ose nëse e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë me të cilin është shqiptuar dënim i tillë;** në këtë rast aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë mundet të ankimohet në bazë të gjitha bazave për të cilat u ankimonte aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Nga kjo mund të kuptojmë se dënimi i shqiptuar nuk është bazë për paraqitjen e ankesës, por është gjendja faktike, a lloji i dënimit të shqiptuar është vetëm kusht për paraqitjen e ankesës.
- 2) Kur gjykata e shkallës së dytë në shqyrtim të mbajtur ka vërtetuar gjendje faktike tjetër nga ajo e shkallës së parë, dhe aktgjykimin e bazon në gjendjen e tillë faktike,** në këtë rast është e mjaftueshme që vetëm të ekzistojë gjendje faktike tjetër e gjykatës së shkallës së dytë nga ajo që ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë.
- 3) Kur gjykata e shkallës së dytë e ndryshon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza dhe ka dhënë aktgjykim me të cilin akuzuari shpallet fajtor,** në këtë rast treshkallshmërinë e arsyeton parimi i dyshkallshmërisë, sepse aktgjykimi marrë në shkallë të dytë është i ndryshëm nga ai i shkallës së parë, dhe paraqet aktgjykim të ri, i cili duhet të kontrollohet nga gjykata më e lartë. Edhe në këtë rast është irelevante dënimi që i është shqiptuar të akuzuarit, por kryesorja është se nga aktgjykim i lirues është marrë aktgjykim dënues.

Nuk ekziston ndonjë dallim i madh ndërmjet ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë. Për ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë vendos Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë si gjykatë e shkallës së tretë dhe më e lartë në sistemin gjyqësor. Në pajtim me procedurën ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë dorëzohet në gjykatën e shkallës së parë, gjykata e shkallës së parë bashkë me shkresat penale e dorëzon në gjykatën e shkallës së dytë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë i bashkangjit edhe shkresat e veta penale dhe e drëzon lëndën në Gjykatën Supreme.

Ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë që është e palejuar dhe jo e paraqitur në kohë do të hedhet me aktvendim nga Gjykata Supreme e RM-së. Vendimet që mund ti merr gjykata e shkallës së tretë janë të njëjta me ato të shkallës së dytë, edhe atë mundet që ta vërtetojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, ta prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe ta ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë. Në shkallë të tretë vendos kolegji gjyqësor që është i përbërë prej pesë gjykatësve profesional. Edhe në këtë procedurë gjykata në tërësi e zbaton principin beneficium cohaesionis, respektivisht këto dispozita do të zbatohen edhe ndaj të akuzuarve tjerë që nuk kanë pasur të drejtë për ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

2.3 Ankesa ndaj aktvendimit

Ankesa kundër aktvendimit është mjet i rregullt juridik me të cilin ankimohen vendimet që merren në procedurë penale në formë të aktvendimeve, për arsye të shkeljeve që mundet të jenë të natyrës faktike ose juridike.

LPP i parasheh tre grupe aktvendimesh të cilat mundet të ankimohen:

- 1) Në grupin e parë bëjnë pjesë të gjitha aktvendimet e gjykatës të procedurës paraprake si dhe aktvendimet tjera të gjykatës të miratuar në shkallë të parë. Palët dhe personat të drejtat e të cilëve janë shkelur, mund të parashtrojnë ankesë çdoherë, kur në ligj nuk është përcaktuar se ankesë e veçantë nuk është e lejuar;**
- 2) Në grupin e dytë bëjnë pjesë aktvendimet e këshillit i përbërë prej tre gjykatësve kundër të cilit nuk lejohet ankesë në procedurë paraprake;**
- 3) Në grupin e tretë bëjnë pjesë aktvendimet që merren më rastin e përgatitjes së shqyrtimit kryesor.**

Ky mjet juridik ka karakter suspensiv, por ka raste në të cilat ka përjashtime. Si shembull, nuk ka karakter suspensiv ankesa kundër aktvendimit të gjykatës të procedurës paraprake me të cilin është përcaktuar paraburgimi.³³

Numri i subjekteve të cilët mund të paraqesin ankesë kundër aktvendimit është i madh. Përveç palëve, mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor të të dëmtuarit, bashkëshorti martesor dhe jashtëmartesor, të afërmit në vijë të drejtë, këtë mjet juridik mundet ta paraqesin edhe të gjithë personat të drejtat e të cilëve janë shkelur. Këtu bëjnë pjesë dëshmitari, eksperti, përkthyesi, të drejtat e të cilëve në çfaëdo lloj forme janë shkelur gjatë procedurës. Ankesa parashtrohet te gjykata e cila e ka sjell aktvendimin.

Afati për paraqitjen e ankësës kundër aktvendimit në parim është tre ditë nga dita e pranimi të aktvendimit. Përveç afati prej tre ditësh, ekziston edhe afat prej 24 orësh, kundër aktvendimit me të cilin është përcaktuar paraburgimi, ose afat prej 8 ditësh për aktvendimin më të cilin shqiptohen masat edukuese ose masat e sigurisë.

³³ Матовски, Никола. Лажетик-Бужаровска, Гордана. Калаџиџев, Гордан. Казнено Процесно Право, Скопје, 2011, fq.366

Bazat(arsyet) për ankesë kundër aktvendimit janë të njëjta me arsyet për ankesë kundër aktgjykimit, edhe atë si vijon:

- A. Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale**
- B. Të shkeljes së Kodit Penal**
- C. Të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike**
- D. Vendimit për dënim**

Përmbajtja e ankesës kundër aktvendimit duhet të jetë ashtu që duhet ti përmbajë këto elemente:

- 1) Të shënohet aktvendimit i cili ankimohet;**
- 2) Ta përmbajë njërin nga katër arsyet për ankesë;**
- 3) Ta përmbajë propozimin deri te gjykata më e lartë që aktvendimi të priset ose të përmisohet;**

Për ankesën kundër aktvendimit vendos gjykata me lartë në seancë të këshillit, dhe mund të marrën tre lloje të vendimeve, vendime më të cilat gjykata:

- 1) E hedh ankesën si të pa afatshme dhe të palejuar;**
- 2) E refuzon ankesën si të pabazë;**
- 3) E pranon ankesën dhe e përmission aktvendimin ose e prish, dhe në bazë të nevojës e kthen lëndën për vendim të sërishëm;**

Kapitulli i III

3. Mjetet e jashtëzakonshme juridike në bazë të LPP të RM-së

Pasi që të jenë të shfrytëzuar të gjitha mjetet e rregullta juridike, dhe pasi gjykata e shkallës më të lartë të ketë marrë vendim për rastin konkret, aktgjykimi e merr formën e prerë, dhe bëhet çështje e gjykuar (*res judicata*). Ky aktgjykim nuk ndryshohet dhe është definitiv. Aktgjykimi i formës së prerë e ka fuqinë e ligjit për çështjen penale konkrete dhe duhet të ekzekutohet.

Por në disa raste të caktuara mundet të zbulohen fakte dhe dëshmi të reja, të cilat parimisht mundet ta ndryshojnë një pjesë të aktgjykimit ose aktgjykimin në tërësi. Në këtë situatë ekziston mundësia që faktet dhe dëshmitë plotësuese të çojnë në ndryshimin e gjendjes faktike në të cilën bazohet aktgjykimi. Në disa raste mundet të paraqitet dyshimi se gjykata gabimisht e ka zbatuar ligjin, respektivisht rethanat e reja tregojnë se gjykata në kufijt e ligjit shumë ashpër e ka shqiptuar dënimin.³⁴

Në të gjitha këto raste LPP bën përjashtim dhe lejon ankimimin e aktgjykimit të formës së prerë. Ankimimi respektivisht atakimi i aktgjykimit të formës së prerë bëhet përmes mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Atakimi i aktgjykimit të formës së prerë me mjet të jashtëzakonshëm juridik mund të bëhet për shkak të gabimeve të natyrës faktike dhe të gabimeve të natyrës juridike.³⁵

Vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike vetëm në favor të personit të dënuar.

Sipas LPP të RM-së, mjete të jashtëzakonshme juridike janë:

1. Rishikimi (përsëritja) e procedurës penale;
2. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë;
3. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm aktgjykimit të formës së prerë;

Më parë edhe si mjet tjetër juridik ka qenë edhe zbutja e jashtëzakonshme e dënimit, por me nryshimet që kanë ndodhur në LPP, ky mjet juridik nuk është i inkorporuar, dhe janë vetëm këto tre mjete. Në ligj janë paraparë në mënyrë taksative afatet për paraqitjen e këtyre mjeteve, subjektet të cilat mundet t'i paraqesin, gjykata kompetente që duhet të vendos, bazat apo arsyet për paraqitjen e mjeteve të jashtëzakonshme juridike si dhe vendimet që mund të merren pasi të jetë goditur aktgjykimi me mjete të jashtëzakonshme juridike.

³⁴ Матовски, Никола. Лажетик-Бужаровска, Гордана. Калаџиџев, Гордан. Казнено Процесно Право, Скопје, 2011, fq.367

³⁵ Sahiti, Ejup. Zejneli, Ismail. Edrejta e Procedurës Penale e RM-së, Shkup, 2017. fq. 290

3.1. Rishikimi i procedurës penale

Në bazë të nenit 446 të LPP-së, procedura penale e cila është kryer me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë, mundet që me kërkesë të personit të autorizuar të përsëritet vetëm në rastet dhe kushtet e përcaktuara me ligj.

Arsyeshmëria e këtij mjeti juridik qëndron në atë se, edhe përkaj ndërgjegjjes së madhe, vëmendjes dhe kujdesit nga ana e gjykatës dhe organeve tjera të procedurës penale, nuk përjashtohet mundësia e vendimeve jo të drejta.³⁶ Baza e këtij mjeti juridik qëndron te gabimet gjatë vërtetimit të gjendjes faktike (*error facti*), në të cilën është i bazuar aktgjykimi i cili e ka marrë formën e prerë, a rishqyrtimi i procedurës penale kërkohet për shkak të fakteve dhe dëshmive të reja para gjykatës, me të cilat më parë nuk është disponuar, të cilat tregojnë mangësitë e vërtetimit të gjendjes faktike.

Me këtë kërkesë nuk mundet të atakohet vendimi për shkak të shkeljeve të ligjit, as që mund të kërkohet që në procedurë të jashtëzakonshme edhe një herë të bëhet vlerësimi i materialit provues i cili është vlerësuar në procedurë të rregullt gjyqësore, sepse kjo don të thotë hapje e një instance gjyqësore. Kërkesa për rishikim të procedurës penale mund të paraqitet kundër aktvendimit me të cilin pushohet procedura penale ose kundër aktgjykimit po që se tregohet se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë jo të drejtë, e kjo vërtetohet me fakte dhe prova të reja.³⁷

Ligji i procedurës penale njihet disa forma të rishikimit të procedurës penale. Dallohen format vijuese:

- 1) Ndryshimi i aktgjykimit të plotëfuqishëm pa përsëritjen e procedurës penale;**
- 2) Vazhdimi i procedurës penale;**
- 3) Përsëritja e procedurës penale në interes të të dënuarit;**
- 4) Përsëritja e procedurës së personit të gjykuar në mungesë;**

3.1.1. Ndryshimi i aktgjykimit të plotëfuqishëm pa përsëritjen e procedurës

LPP parasheh mundësinë e ndryshimit të aktgjykimit të plotëfuqishëm pa përsëritjen e e procedurës penale. Sipas nenit 447 aktgjykimi i plotëfuqishëm mund të ndryshojë nëse:

- 1) Në dy ose më tepër aktgjykime kundër të njëjtit person janë shqiptuar më shumë dënime, a nuk janë zbatuar dispozitat mbi caktimin e dënimit unik për vepra penale në bashkim;

³⁶ Матовски, Никола. Лажетик-Бужаровска, Гордана. Калаџиџев, Гордан. Казнено Процесно Право, Скопје, 2011, fq.367

³⁷ Sahiti, Ejup, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005, fq.240

- 2) Me rastin e shqiptimit të dënimit unik sipas dispozitave për vepra penale në bashkim, është përfshirë edhe dënimi i cili, sipas dispozitave mbi dënimin unik, është përfshirë në dënimin e shqiptuar në ndonjë aktgjykimi të mëparshëm;
- 3) Pas formës së prerë të aktgjykimit paraqiten rethana që nuk kanë qenë kur është shpallur aktgjykimi, ose nuk kanë qenë të njohura edhe pse kanë ekzistuar, e ato qartazi do të sjellnin deri te një dënim më i butë;
- 4) Aktgjykimi i formës së prerë, me të cilin për disa vepra penale është shqiptuar një dënim unik, nuk mund të ekzekutohet në një pjesë për shkak të amnistisë, faljes, ose për shkaqe të tjera;
- 5) Pas formës së prerë të aktgjykimit me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor për vepër penale të vazhduar paraqiten persona të dëmtuar të ri, gjykata e shkallës së parë do ta ndryshojë aktgjykimin në pjesën lidhur me kërkesën pasurore juridike, kurse procedura është zhvilluar në bazë të propozimit të të dëmtuarëve brenda afatit prej tre muajve nga dita kur janë njoftuar për aktgjykimin.

Në qoftë se ekziston ndonjëra nga pikat e lartë përmendura, ndryshim të aktgjykimit kanë të drejtë të kërkojnë prokurori publik dhe i dëmtuari, ndërsa aktgjykimin e ri e sjell gjykata në seancë të kolegjit, i cili e ka shqiptuar dënimin e mëparshëm, pas dëgjimit edhe të palës kundërshtare.³⁸

Duhet konstatuar se në këtë rast kemi të bëjmë me ndryshimin e aktgjykimit duke i pasur për bazë dënimet e shqiptuara në procedurat e mëparshme, prandaj nuk është fjala për përsëritje të procedurës penale në kuptimin e plotë të fjalës. Në këtë rast shtrohet pyetja se cila gjykatë është kompetente për të vendosur? Kompetente për të vendosur është gjykata e shkallës së parë që e ka gjykuar çështjen në të cilën është shqiptuar lloji më i rëndë i dënimit; për dënime të njëllajta gjykata e cila e ka shqiptuar dënimin më të madh; kur dënimet janë të njëjta, gjykata e cila e fundit e ka shqiptuar dënimin. Me rastin e ndryshimit të aktgjykimit, gjykata duhet të ua dërgoj nga një kopje të vërtetuar të aktgjykimit të formës së prerë edhe gjykatave vendimet e të cilave i ka marr parasysh me rastin e ndryshimit të aktgjykimit.³⁹

3.1.2. Vazhdimi i procedurës penale

Procedura penale e pushuar me aktvendim për shkak të ekzistimit të pengesave procedurale, mund të vazhdohet po sa të eliminohen ato pengesa. Sipas nenit 448 të LPP-së, procedura mund të vazhdohet nëse: **gjykata ka refuzuar ta konfirmojë aktakuzën; kur para fillimit të shqyrtimit gjyqësor aktakuza është hedhur; kur me aktgjykim akuza është refuzuar në formë të prerë; me kërkesë të paditësit të autorizuar mund të lejohet përsëritja e procedurës penale kur parashtrohen prova të reja në bazë të të cilave gjykata mund të bindet se janë plotësuar kushtet për përsëritje të procedurës penale.**

³⁸ Матовски, Никола. Лажетик-Бужаровска, Гордана. Калајчиев, Гордан. Казнено Процесно Право, Скопје, 2011, fq.374

³⁹ Sahiti, Ejup. Zejneli, Ismail. Edrejta e Procedurës Penale e RM-së, Shkup, 2017. fq. 292

Procedura penale e pushuar në formë të prerë deri në fillimin e shqyrtimit gjyqësor mund të përsëritet kur prokurori publik tërhiqet nga aktakuza dhe vërtetohet se tërheqja është pasojë e veprës penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare të prokurorit publik.

3.1.3. Përsëritja e procedurës penale në interes të të dënuarit

LPP parasheh mundësinë e rishikimit të procedurës penale e cila ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë. Sipas nenit 449 të LPP-së të RM-së, procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të përsëritet në interes të të dënuarit nëse:

- 1) Provohet se aktgjykimi është bazuar në dokument të rrejshëm, inçizim audio vizuel ose në deklaram të rrejshëm të dëshmitarit, të ekspertit, ose të përkthyesit, përkatësisht interpretuesit;
- 2) Provohet se aktgjykimi është pasojë e veprës penale të kryer nga gjykatësi, gjykatësi porot ose personi që ka ushtruar veprime hetimore;
- 3) Paraqiten fakte të reja ose parashtrohen prova të reja të cilat vetë ose së bashku me provat e mëparshme janë të përshtatshme që të arsyetojnë lirimin e personit që ka qenë i dënuar ose dënimin e tij sipas ndonjë dispozite më të butë penale;
- 4) Një person për të njëjtën vepër penale është dënuar disa herë ose nesë më tepër persona janë dënuar për vepër të njëjtë që ka mund ta kryejë vetëm një peson ose disa prej tyre;
- 5) Në rastin e dënimit për vepër penale të vazhduar ose veprave të tjera penale të cilat sipas ligjit përfshijnë disa vepra të njëjta ose të ndryshme, zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat tregojnë se i dënuari nuk ka kryer vepër që është përfshirë në veprën penale për të cilën ai është dënuar dhe ekzistimi i fakteve të tilla do të ishte me ndikim qenësor në përcaktimin e dënimit;
- 6) Me vendim të plotëfuqishëm të gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut është vërtetuar shkelja e të drejtave dhe lirive themelore gjatë procedurës;

Kërkesa për rishikim të procedurës penale mund të paraqitet edhe pasi që i dënuari e ka mbajtur dënimin dhe pa marrë parasysh faktin se vepra penale është parashkruar, amnistuar ose falur.⁴⁰

Në kërkesë për rishikim të procedurës penale duhet të shënohet se sipas cilës bazë ligjore kërkohet rishikim i procedurës dhe se në çfarë provash argumentohen faktet në të cilat mbështet kjo kërkesë. Kërkesa për rishikim të procedurës në dobi të të gjykuarit nuk është e lidhur me afat. Ajo, mund të paraqitet dhe pas mbajtjes së dënimit nga i akuzuari.

⁴⁰ Po aty, fq.293

3.1.4. Personat e autorizuar që të parashtrojnë kërkesë për përsëritjen e procedurës

Në bazëtë nenit 451 të LPP kërkesë për përsëritjen e procedurës mund të parashtrojnë: palët dhe mbrojtësi, kurse pas vdekjes së të dënuarit kërkesë mund të parashtrojë edhe prokurori publik nëse procedura është mbajtur me kërkesë të tij, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, të afërmit në vijë të drejtë, prindi, adaptuesi, fëmija i adpatuar, vëllai, motra ose mbajtësi.

Nëse gjykata që do të ishte kompetente për vendosje për përsëritjen e procedurës penale, njoftohet se ekziston arsye për përsëritjen e procedurës penale, do ta njoftojë për këtë të dënuarin, përkatësisht personin i cili është i autorizuar që ta parashtrojë kërkesën.

3.1.5. Gjykata e cila vendos për kërkesën dhe përmbajtja e kërkesës

Për kërkesën për përsëritje të procedurë penale vendos kolegji i përbërë nga tre gjykatës, i gjykatës e cila e ka gjykuar çështjen penale konkrete në shkallë të parë, këtu duhet pasur kujdes që në kolegji të mos merr pjesë gjykatësi i cili ka gjykuar në shkallë të parë. Në kërkesë duhet patjetër të theksohen se sipas cilës bazë ligjore paraqitet kërkesa për përsëritje të procedurës, cilat janë faktet e reja të cilat do të ndikonin në ndryshimin e aktgjyimit të mëparshëm. Nëse kërkesa nuk i përmban këto të dhëna, gjykata do ta thirrë personin i cili e ka paraqitur kërkesën që në afatin e caktuar ta plotësojë, respektivisht ta përmisojë kërkesën.

3.1.6. Vendosja për kërkesën për përsëritje të procedurës penale

Gjykata me aktvendim do ta hedh kërkesën nëse në bazë të vet kërkesës dhe të shkresave penale nga procedura e mëparshme, vërteton se kërkesën e ka paraqitur personi i paautorizuar ose nuk ka kushte ligjore për përsëritjen e procedurës, ose faktet dhe provat mbi të cilat mbështetet kërkesa tanimë veç se janë paraqitur në kërkesën e mëparshme që është refuzuar me aktvendim të plotëfuqishëm të gjykatës, ose shihet qartë se faktet dhe provat nuk janë të përshtatshme që në bazë të tyre të lejohet përsëritja, ose vërtetohet se bëhet fjale për dokument të rrejshëm ose dëshmi të rrejshme të dëshmitarit ose ekspertit. Nëse gjykata nuk e hedh kërkesën, do të dorëzohet kopje e kërkesës te pala kundërshtarë e cila ka të drejtë në afat prej tetë ditësh t'i përgjigjet kërkesës. Kur gjykatës do t'i arrijë përgjigja ndaj kërkesës ose kur do kaloj afati për dhënien e përgjigjes, kryetari i kolegjit do të caktojë që të hetohen faktet dhe të grumbullohen provat. Pas hetimeve të realizuara gjykata me aktvendim menjëherë do të vendos për kërkesën për përsëritjen e procedurës. Në raste tjera kur janë në pyetje vepra penale për të cilat ndjekja bëhet sipas detyrës zyrtare, kryetari i kolegjit do të përcaktojë që shkresat të dërgohen te prokurori publik kompetent i cili pa prolongim dhe vonesa do t'i kthejë të gjitha shkresat penale së bashku me mendimin e vet.

3.1.7. Leja për përsëritjen e procedurës ose refuzimi i kërkesës për përsëritjen e procedurës

Sipas nenit 454 të LPP-së të RM-së, kur prokurori publik do t'i kthejë shkresat, nëse nuk përcakton që hetimi të plotësohet në bazë të rezultateve nga hetimi, gjykata do ta pranojë kërkesën dhe do të lejojë përsëritjen e procedurës penale, ose do ta refuzojë kërkesën nëse provat e reja nuk janë të mjaftueshme për përsëritjen e procedurës penale. Nëse gjykata vërteton se shkaqet për të cilat ka lejuar përsëritjen e procedurës ekzistojnë edhe për ndonjë prej të bashkëakuzuarve tjerë që nuk ka paraqitur kërkesë për përsëritje të procedurës, do të veprojë sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) sikur të ekzistojë një kërkesë e tillë.

Në aktvendimin me të cilin lejohet përsëritja e procedurës penale gjykata do të vendos menjëherë që të caktohet seancë e re, ose lënda të kthehet në procedurën hetimore. Kur aktvendimi me të cilin lejohet përsëritja e procedurës penale do të bëhet i plotëfuqishëm përkatësisht do të marrë formën e prerë, do të ndërpritet zbatimi i dënimit, por gjykata me propozim të prokurorit publik do të përcaktojë paraburgim nëse ekzistojnë kushtet e përcaktuara me ligj.

3.1.8. Rregullat për procedurën e re

Për procedurën e re që udhëhiqet në bazë të aktvendimit me të cilin lejohet përsëritja e procedurës penale, vlejnë dispozitat si edhe për procedurën e parë. Nëse procedura e re ndërpritet deri në fillimin e shqyrtimit gjyqësor, gjykata me aktvendim për ndërprerjen e procedurës do ta anulojë edhe aktgjykimin e mëparshëm.

Kur gjykata në procedurën e re miraton aktgjykim, do të shqiptojë se aktgjykimi i mëhershëm pjesërisht ose tërësisht shfuqizohet ose mbetet në fuqi. Në dënimin që do e shqiptojë me aktgjykim të ri, gjykata të akuzuarit do t'ia llogarisë dënimin e mbajtur, e kur përsëritja është përcaktuar vetëm për ndonjërin nga veprat për të cilat i akuzuari ka qenë i dënuar, gjykata do të shqiptojë dënim të ri vetëm sipas dispozitave të Kodit Penal.

3.1.9. Përsëritja e procedurës së personit të dënuar në mungesë

Prezenca e të akuzuarit në procedurë penale është një prej komponentave të rëndësishme për gjykim të drejtë. Në legjislacionin proceduralo-penal të Republikës së Maqedonisë, ndonëse me rastin e zbatimit të procedurës penale çdoherë bëhen përpjekje që të sigurohet prezenca e të akuzuarit, në kushtë të caktuara gjykimimi mund të zhvillohet në mungesë të tij.⁴¹

Legjislacioni jonë penal parasheh se i akuzuari mundet edhe të gjykohet në mungesë vetëm nëse është në arrati ose është i pakapshëm për organet shtetërore, por ekzistojnë arsye që të dënohet në mungesë. Karakteristikë e këtij lloji të përsëritjes së procedurës penale qëndron në atë se për parashtrimin e kërkesës

⁴¹ Po aty, fq.295

për përsëritjen e procedurës penale nuk nevojitet që të plotësohen kushtet tjera të parapara me ligj, por duhet të plotësohet vetëm një kusht, e ai është që i akuzuari të jetë dënuar me aktgjykim të plotëfuqishëm në mungesë, dhe përsëri të rigjykohej çështja në prezencë të të akzuarit.

Subjekte të cilat janë të autorizuar që të paraqesin kërkesë për përsëritje të procedurës penale janë:

a) i dënuari

b) mbrojtësi i tij.

Afati për parashtrimin e kërkesës për përsëritje të procedurës penale për personin e dënuar në mungesë është një vit nga dita kur i dënuari është njoftuar me aktgjykimin me të cilin është dënuar në mungesë, pra, procedura penale nuk përsëritet në bazë të detyrës zyrtare, por vetëm me kërkesë të të dënuarit dhe mbrojtësit të tij.

Në aktvendimin me të cilin lejohet përsëritja e procedurës penale, gjykata do të përcaktojë që të akzuarit t'i dorëzohet aktakuza, nëse më parë nuk i është dorëzuar, por mundet edhe të caktojë që lënda të kthehet në procedurë hetimore, përkatësisht të zbatohet hetim, nëse nuk ka pasur. Gjkata nuk do të lejojë gjykim të përsëritur në mungesë të të akzuarit të cilit i është pranuar kërkesa për përsëritje të procedurës për shkak të gjykimit në mungesë, nëse gjatë procedurës së përsëritur bëhet i pakapshëm për organet e ndjekjes.

Qëllimi kryesor i këtij lloji të përsëritjes së procedurës penale është që të gjykuarit në mungesë t'i shqiptohet dënimi në procedurë të rregullt, kur ajo të bëhet e mundur dhe ta kërkojë i dënuari. Procedura e re do të rrjedhë si çdo procedurë tjetër e shkallës së parë, kompetente për zbatimin e saj është gjykata e cila në procedurën e mëparshme ka gjykuar në shkallë të parë. Edhe në këtë procedurë vlen rregulla e ndalimit për ndryshim në të keq, pra pozita e të akzuarit nuk mund të keqësohet dhe me aktgjykimin e ri dënohet edhe më rëndë se me aktgjykimin e mëparshëm.⁴²

Pra gjykata gjatë marrjes së aktgjykimit të ri duhet në çdo rast të respektojë parimin **Reformatio in Peius**, që domethënë se nëse është paraqitur kërkesë për përsëritjen e procedurës penale për të dënuarin në mungesë, kërkesa është paraqitur vetëm në dobi të të akzuarit, aktgjykimi i ri përsa i përket cilësimit juridik të veprës dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të tij.

⁴² Матовски, Никола. Лажетик-Бужаровска, Гордана. Калаџиџев, Гордан. Казнено Процесно Право, Скопје, 2011, fq.373

3.2. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

Sipas nenit 457 të LPP të RM-së kundër vendimeve gjyqësore të formës prerë Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë mund të parashtrojë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nëse është shkelur Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, ligji, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Për dallim nga mjeti tjetër juridik siç është kërkesa për rishikim të procedurës penale e cila për bazë ka gabimet e natyrës faktike, respektivisht gjendja faktike e vërtetuar gabimisht nga ana e gjykatës, ndërsa kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë për bazë nuk ka gjendjen faktike të vërtetuar gabimisht, por ka për bazë të metat ligjore që mund t'i ketë aktgjykimi i formës së prerë.

Në krahasim me mjetet tjera juridike, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ka dy karakteristika të veçanta, siç janë:

- mund ta shfrytëzojë vetëm prokurori publik, e jo palët tjera që janë pjesëmarrëse në proces, dhe këtu prokurori publik nuk paraqitet si palë në procedurë, por si mbrojtës i parimit të ligjshmërisë;
- me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, mund të goditen edhe procedura gjyqësore që i ka paraprijë vendimeve të formës së prerë, dhe jo vetëm vendimit gjyqësor, siç është rasti me mjetet tjera juridike;

Qëllimi kryesor i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë është që të sigurojë zbatim të parimit të ligjshmërisë në punën e gjykatës dhe njëkohësisht të arrihet zbatim i së drejtës. Me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të goditen të gjitha vendim e plotëfuqishme, pa marrë parasysh se në cilën instancë janë sjellur, nëse kundër tyre ka qenë i lejuar ose është shfrytëzuar mjet i rregullt juridik. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është një mjet efikas për revidimin e vendimeve gjyqësore me të cilin janë shkellur dispozitat ligjore.⁴³

3.2.1. Subjektet dhe afatet

I vetmi subjekt i cili mund të paraqes kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë është Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë. Meqë këtë mjet juridik mund ta paraqes vetëm prokurori publik, i cili paraqitet si organ shtetëror në mbrojtje të ligjshmërisë, palët duhet që ti drejtohen atij si organ shtetëror, që të inicojnë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

LPP nuk e parasheh ndonjë afat të caktuar për paraqitjen e këtij mjetu juridik, që domethënë se paraqitja e këtij mjeti juridik nuk është e kufizuar në aspektin kohor.

⁴³ Po aty, fq.278

3.2.2. Vendosja për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruar nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë, parashtrohet deri te Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë. Gjykata Supreme vendos në seancë të kolegjit në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Po që se gjykata nuk e hedh poshtë kërkesën, një kopje të saj ia dërgon palës tjetër për përgjigje në kërkesë. Para se lënda të paraqitet për zgjidhje, gjykatësi raportues sipas nevojës, mundet të marrë njoftim për shkeljet ligjore të theksuara në kërkesë.

Gjatë vendosjes për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, gjykata do të kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljeve ligjore të cilat thirret paraqitësi i kërkesës (*reformation in peius*), që domethënë ndalimi i ndryshimit për më keq.

Nëse gjykata konstaton se shkaqet për të cilat e ka miratuar vendimin në dobi të të gjykuarit ekzistojnë edhe për ndonjë nga të bashkëgjykuarit tjerë, të cilët nuk kanë paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, sipas detyrës zyrtare do të veprohet sikur të kishte ekzistuar një kërkesë e tillë (*beneficium cohaesionis*).

3.2.3. Vendimet e Gjykatës Supreme

Me rastin e vendosjes për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë mund të marrë ndonjërin nga vendimet vijuese:

- ta hedh poshtë kërkesën me aktvendim, nëse prokurori publik e tërheq kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë;
- gjykata me aktgjykim do ta refuzojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazë, nëse vërteton se nuk ekziston shkelje ligjore në të cilën pretendon prokurori publik në kërkesë;
- të vërtetojë se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar, dhe varësisht nga shkeljet ligjore mundet të marrë ndonjërin nga vendimet vijuese:

1) do ta ndryshojë vendimin e formës së prerë;

2) në tërësi ose pjesërisht prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës më të lartë, ose vetëm vendimin e gjykatës më të lartë dhe lëndën ia kthen gjykatës së shkallës së parë ose gjykatës më të lartë për vendim të ri ose për gjykim të ri;⁴⁴

3) do të kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit;

Nëse aktgjykimi i plotfuqishëm është prishur dhe lënda është kthyer për rigjykim, në gjykimin e ri për bazë do të merret aktakuza e mëparshme ose ajo pjesë e saj e cila ka të bëjë me pjesën e prishur të aktgjykimit. Para gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të ofrojnë faktë të

⁴⁴ Neni 460, Ligji i Procedurës Penale i RM-së

reja dhe të parashtrajnë prova të reja dhe të propozojnë zbatimin e veprimeve procedurale për shpjegimin e çështjeve për të cilat ka sugjeruar Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë.⁴⁵

3.3. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm është mjet i jashtëzakonshëm juridik me të cilin, sikur me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, atakohet aktgjykimi i formës së prërë për shkak të shkeljes së ligjit. Ky mjet juridik është gati identik me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë me disa veçori që kanë të bëjnë me atë se kush janë personat e autorizuar për paraqitjen e saj si dhe sa u përket bazave për paraqitje.⁴⁶

Si argumente për këtë mjet juridik janë:

- është e papranueshme që prokurori publik si organ shtetëror i cili e ka funksionin e ndjekjes penale, të ketë të drejtë të vlerësojë a është shkelur ligji, a këtë të drejtë të mos e kenë qytetarët në dëm të të cilëve është shkelur ligji;
- e drejta e qytetarëve për të disponuar me këtë mjet juridik, nuk e ndryshon të drejtën e prokurorit publik që të intervenojë me anë të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë;
- dhënia e kësaj të drejte qytetarëve, ndihmon në realizim e qëllimit në rolin që ka Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë për unifikimin e jurisprudencës;
- kjo e drejtë e qytetarëve është e kufizuar dhe e reduktuar vetëm në shkelje të caktuara ligjore, të cilët kanë shkaktuar ose kanë mundur të shkaktojnë dëm të konsiderueshëm të gjykuarit;⁴⁷

Në bazë të nenit 463 të LPP-së të RM-së, si kushtë për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm janë:

- 1) Personi i cili me aktgjykim të plotëfuqishëm është dënuar me dënim me burgim pa kusht ose me burgim për të mitur, pa marrë parasysh kohëzgjatjen e dënimit;
- 2) Kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm parashtrohet në afat prej 30 ditëve, nga dita kur i akuzuari e ka pranuar aktgjykimin e plotëfuqishëm;
- 3) I dënuari që nuk ka shfrytëzuar mjet të rregullt juridik kundër aktgjykimit, nuk mund të paraqesë kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm vetëm nëse më aktgjykimin e shkallës së dytë në vend të lirimit nga dënimi, vërejtjes gjyqësore, dënimit me kusht ose dënimit me para është shqiptuar dënim me burgim, përkatësisht në vend të masës edukative – dënim me burgim për të mitur.

⁴⁵ Neni 462, Ligji i procedurës penale i RM-së

⁴⁶ Sahiti, Ejup. Zejneli, Ismail. Edrejta e Procedurës Penale e RM-së, Shkup, 2017. fq. 297

⁴⁷ Матовски, Никола. Лажетик-Бужаровска, Гордана. Калаџијев, Гордан. Казнено Процесно Право, Скопје, 2011, fq. 381

3.3.1. Bazat për paraqitjen e kërkesës

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm, mund të paraqitet për shkak të shkeljes së:

- 1) Shkeljes së Kodit Penal në dëm të të dënuarit të parashikuar në nenin 416, pikat 1), 2), 3), dhe 4) të LPP-së, ose për shkak të shkeljes nga neni 416, pika 5), kur tejkalimi i autorizimit ka të bëjë me vendimin mbi dënimin, masën alternative ose konfiskimin e pronës dhe dobisë pronësore;
- 2) Për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale të parashikuara në nenin 415, paragrafi (1), pikat 1), 5), 8), 9), dhe 10) të LPP-së;
- 3) Për shkak të shkeljes së të drejtave të dënuarit për mbrojtje në shqyrtim gjyqësor, ose për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale në procedurën ankimore, kur kjo shkelje ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të drejtë dhe të ligjshëm osë në të drejtën e të pandehurit në gjykim të drejtë.

3.3.2. Subjektet që mund të paraqesin kërkesë

Kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm mundet ta paraqesin vetëm i gjykuari dhe mbrojtësi i tij. Të dy subjektet janë të pavarur në paraqitjen e kësaj kërkesë, ndërsa për shfrytëzimin e kësaj të drejtë mbrojtësit nuk i nevojitet pëlqim nga i akuzuari.

3.3.3. Vendosja për kërkesën

Për këtë kërkesë kompetente është Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm i dorëzohet gjykatës që e ka miratuar aktgjykimin në shkallë të parë. Kërkesa që është paraqitur jo me kohë ose e ka paraqitur personi i paautorizuar ose është paraqitur në rast të gjykimit të sanksionit penal për shkak të cilit kërkesa nuk mund të paraqitet, ose sipas ligjit nuk është e lejuar, ose kur parashtuesi heq dorë nga kërkesa, kryetari i kolegjit do ta hedh poshtë me aktvendim. Gjykata kompetente për vendimmarrje i dorëzon ekzemplarë nga kërkesa, paditësit që vepron para kësaj gjykate, i cili mundet në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të parashtrojë përgjigje. Gjykata kompetente për vendimmarrje, duke marrë parasysh përmbajtjen e kërkesës mundet të përcaktojë që të anulohet përkatësisht të ndërpritet zbatimi i aktgjykimit të plotëfuqishëm.

Për dallim nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, me rastin e vendosjes për kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm, gjykata nuk mund të kufizohet në atë që vetëm ta vërtetojë shkeljen ligjore, respektivisht të sjell aktgjykim deklarativ në të cilin vetëm e konstaton shkeljen ligjore. Edhe te kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, njëjtë sikur te kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë gjykata është e lidhur me parimin *reformatio in peius*.

Kapitulli IV

4. Krahasoni i mjeteve juridike

Në këtë punim, një kapitull të veçantë i'a kam kushtuar krahasimit të mjeteve juridike me vendet tjera. Si vende me të cilat do të bëhet krahasimi është Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë. Do të trajtojë se cili është dallimi ndërmjet mjeteve juridike në procedurë penale në mes Republikës së Maqedonisë dhe vendeve të lartëpërmendura, clat janë pikat e përbashkëta të zhvillimit të procedurës lidhur me mjetet juridike, ku ata ndryshojnë prej njëra tjetrës, përparësitë që mundet ti kenë procedura lidhur me mjetet juridike në vendet përkatëse, a duhet që ndonjë mjet juridik që nuk është i përfshirë në vendin tonë, që të përfshihet në LPP, cilat janë arsyet apo bazat e përdorimit të mjeteve juridike në këto vende, do të përshkruaj llojet e mjeteve juridike në këto vende. Procedura penale në përgjithsi, dhe procedura lidhur me mjetet juridike në veçanti nuk kanë ndonjë dallim të madh ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe vendeve fqinje, meqë jemi vende në tranzicion demokratik, shumica e ligjeve janë thuajse të njëjta, sepse vetëm merren si shembull nga vendet tjera më të zhvilluara.

4.1. Mjetet juridike në bazë të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Sipas nenit 374 të KPPRK, pala mund të paraqes mjetin juridik përmes:

- 1) Ankesës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit
- 2) Ankesës kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme të Kosovës
- 3) Ankesës kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit
- 4) Kërkesës për mjetin e jashtëzakonshëm juridik nga Gjykata Themelore apo Gjykata e Apelit në Gjykatën Supreme

4.1.1. Ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit

Kundër aktgjykimit të marrë nga gjyqtari i vetëm ose trupi gjykues, në afat prej 15 ditësh mund të paraqitet ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Ankesa e personit të autorizuar e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit. Personat e autorizuar për paraqitjen e ankesës janë të paraparë në mënyrë taksative në nenin 381 të KPPRK.

Si arsye për ushtrimin e ankesës ndaj aktgjykimit janë:

- 1) Për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- 2) Për shkak të shkeljes së ligjit penal;
- 3) Për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike;

- 4) Për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, shpenzimeve të procedurës penale, kërkesave pasurore juridike, si dhe për shkak të vendimit mbi publikimin e aktgjykimit;

Edhe në procedurën penale të Kosovës njëjtë si edhe në Maqedoni, gjatë marrjes së vendimeve nga ana e gjykatave më të larta, janë të lidhura me parimet *reformation in peius* dhe *beneficum cohaesionis*. Që nënkuptojnë se ankesa është paraqitur vetëm në dobi të të akuzuarit, aktgjykimi i ri nuk mund të shkojë në dëm të tij, respektivisht se me rastin e paraqitjes së ankesës nga cilido i akuzuar, arsyet për të cilat ka marrë vendim shkojnë në dobi të akuzuarit, atëher ato shkojnë edhe në dobi të të gjithë bashkëakuzuarve tjerë.

Ndaj aktgjykimit nuk mund të ushtrohet ankesë për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike kur ka marrëveshje për pranim të fajësisë apo kur i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me pranimin e tillë.

Ankesa kundër aktgjykimit i paraqitet gjykatës e cila e ka nxjerr aktgjykimin, kjo gjykatë i përcjell ankesën dhe shkresat tjera në gjykatën që është kompetente për shqyrtimin e lëndës. Kur gjykata e Apelit pranon lëndën me ankesë, ato ia dorëzon kryetarit të kolegjit sipas orarit të gjykatës. Gjykata e Apelit merr vendim në seancë të kolegjit ose në shqyrtim, në seancë të kolegjit vendos nëse do të mbajë shqyrtim.

Vendimet që mund t'i marr Gjykata e Apelit në seancë të kolegjit ose në bazë të shqyrtimit janë:

- 1) E hudhë ankesën si të paafatshme ose të palejuar;
- 2) E refuzon ankesën si të pabazë dhe e vërteton aktgjykimin e gjykatës themelore;
- 3) E anulon aktgjykimin dhe çështjen ia kthen gjykatës themelore për rigjykim;
- 4) E ndryshon aktgjykimin;⁴⁸

Ankesa e cila paraqitet pas skadimit të afatit ligjor i cili është i paraparë për paraqitjen e ankesës, me aktvendim do të hudhet si e paafatshme.

Në arsyetimin e aktgjykimit apo të aktvendimit, Gjykata e Apelit vlerëson pretendimet e ankesës dhe tregon shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare. Gjykata e Apelit pasi të ketë marr vendimin, ia kthen të gjitha shkresat gjykatës themelore bashkë me kopje të mjaftueshme për t'ua dërguar palëve.

Kur aktgjykimi i gjykatës themelore anulohet pjesërisht, gjykata merr për bazë atë pjesë të akuzës që ka të bëjë me pjesën e anuluar të aktgjykimit, në shqyrtimin e ri gjyqësor palët kanë të drejtë të prezentojnë faktë dhe prova të reja.

⁴⁸ Neni 398, KPPRK, Nr. 04/L-123

Gjykata themelore ndërmerr të gjitha veprimet procedurale dhe shqyrton të gjitha çështjet kontestuese të theksuara në vendimin e apelit.

4.1.2. Ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme të Kosovës

Ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit mund të paraqitet në Gjykatën Supreme në rastin kur Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin lirues të gjykatës themelore dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin, ose kur me aktgjykim të Gjykatës Themelore, ose Gjykatës së Apelit i është shqiptuar dënim me burg të përjetshëm.

Aktgjykimet e Gjykatës Supreme nënshkruhen nga të gjithë gjyqtarët e kolegjit, një anëtar i kolegjit mund të paraqesë mendim të ndarë, mospajtues ose pajtues mbi çështje ligjore ose faktike lidhur me nkesën dhe mendimi i tillë i bashkangjitet aktgjykimit.

4.1.3. Ankesa kundër aktvendimit

Sipas KPPRK, ankesa kundër aktvendimit është e lejueshme me rastin e disa aktvendimeve, gjegjësisht kundër disa aktvendimeve. Duke pasur parasysh se në procedurën penale merren shumë aktvendime, ligji parasheh se kundër aktvendimeve të gjyqtarit paraprak dhe kundër të tjerave të nxjerra në shkallën e parë, palët dhe personat, të drejtat e të cilëve janë cënuar gjithmonë mund t'i kundërshtojnë kur në kod nuk është ndaluar në mënyrë eksplicite ankesa.⁴⁹

Kundër aktvendimit të marrë në procedurë paraprake nga kolegji shqyrtues i përbërë nga tre gjyqtarë nuk lejohet ankesë, me përjashtim të rasteve kur kodi nuk e parasheh ndryshe.⁵⁰ Ndërkaq kundër aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nuk lejohet ankesë.

Ankesa i paraqitet gjykatës e cila e ka marrë vendimin, ankesa kundër aktvendimit paraqitet brenda tre ditëve nga dita e dorëzimit të aktvendimit. Paraqitja e ankesës e pezullon ekzekutimin e aktvendimit ndaj të cilit është ushtruar ankesë.

Ankesa kundër vendimit të gjykatës themelore paraqitet nga ankuesi në gjykatë themelore, gjykata themelore i dërgon palës kundërshtare kopjen e ankesës, gjykata themelore ja përcjellë ankesën dhe shkresat tjera Gjykatës së Apelit, nëse paraqitet ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, atëherë ajo dorëzohet në këtë gjykatë dhe kjo ja përcjellë Gjykatës Supreme të Kosovës. Kur gjykata e Apelit pranon ankesë kundër aktvendimit kolegji mund të vendos për mbajtjen e seancës në të cilën njoftohen: prokurori kompetent i shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësi i tij.

⁴⁹ Çoliq-Sirjeçiq, Hajrija. Halilović, Haris. E drejta e Procedurës Penale Më vështrim të posaçëm në procedurën penale të Kosovës, Prishtinë, 2007, fq.201

⁵⁰ Neni 408, paragrafi 2, KPPRK, Nr. 04/L-123

Arsyet e ankesës kundër aktvendimit janë, kur me aktvendim shkelet:

- 1) Të drejtën e cila i njihet palës me Kushtetutë;
- 2) Të drejtën thelbësore të palës të paraparë me KPPRK;
- 3) Të drejtën thelbësore të palës të paraparë me ndonjë ligj tjetër të Kosovës;
- 4) Të drejtën procedurale;⁵¹

Kur vendos për ankesë, gjykata me aktvendim mund ta hudhë ankesën si të paafatshme ose të papranueshme, ta refuzojë si të pabazë, ta aprovojë ankesën dhe ta ndryshojë aktvendimin ose ta anulojë dhe, sipas nevojës, çështjen ta kthejë për rivendosje.

4.1.4. Mjetet e jashtëzakonshme juridike

Pasi që të jetë paraqitur mjeti i rregullt juridik, dhe të jetë nxjerrë vendimi për të, apo kur subjektet e autorizuar nuk e shfrytëzojnë këtë të drejtë, aktgjykimi i gjykatës e merr formën e prerë. Forma e prerë e aktgjykimit ka karakter të sigurisë juridike, për arsye se çdo procedurë penale në momentin e caktuar duhet të jetë e përfunduar. Forma e prerë e aktgjykimit është edhe supozim për ekzekutimin e aktgjykimit. Vetëm përjashtimisht mund të shqyrtohet aktgjykimi i gjykatës, pas formës së prerë, me anë të mjeteve juridike të jashtëzakonshme. Aktgjykimi i formës së prerë mund të jetë i padrejtë kur ai bazohet në konstatime jo të sakta të gjendjes faktike apo kur me aktgjykim të gjykatës shkelen dispozitat ligjore.⁵²

Mjetet e jashtëzakonshme juridike në bazë të KPPRK janë:

- 1. Rishikimi i procedurës penale;**
- 2. Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit;**
- 3. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë;**

E përbashkëta e këtyre tre mjeteve juridike të jashtëzakonshme është se janë të drejtuara kundër vendimeve të plotëfuqishme, por se të njëjtat dallojnë në shikim të përbërjeve, kështu kërkesa për rishikim dhe kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit kanë të bëjnë me përmisimin e gjendjes faktike, ndërsa kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ka të bëjë me mënjanimin e shkeljeve ligjore, por dallojnë edhe në atë se kërkesa për rishikim dhe kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit janë mjete juridike të palës dhe si të tilla kanë karakter ekskluziv unilateral (me rastin e suksesit ekziston gjithnjë gjykimi i aktgjykimit të sulmuar), faktikisht janë të drejtuara vetëm kundër aktgjykimit, dhe se në drejtim të të njëjtave ekziston

⁵¹ Neni 414, paragrafi 1, KPPRK, Nr. 04/L-123

⁵² Çoliq-Sirjeçiq, Hajrija. Halilović, Haris. E drejta e Procedurës Penale Më vështrim të posaçëm në procedurën penale të Kosovës, Prishtinë, 2007, fq.201

intervali kohor i kufizuar, ndërsa kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është mjet juridik të cilin mund ta ushtrojë Prokurori i Shtetit Kosovës, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.⁵³

4.1.4.1. Rishikimi i procedurës penale

Procedura penale e përfunduar me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet me kërkesën e personave të autorizuar vetëm në rastet dhe sipas kushteve të përcaktuara me KPPRK.

KPPRK njeh disa variante të rishikimit të procedurës penale, edhe atë:

- 1) Ndryshimi i aktgjykimit të formës së prerë pa rishikim të procedurës penale;
- 2) Vazhdimi i procedurës;
- 3) Rishikimi i procedurës penale me aktvendim të formës së prerë;
- 4) Rishikimi i procedurës penale të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë;

Nuk do të hyjmë në detaje për të sqaruar secilën nga variantet e mundshme të përsëritjes së procedurës penale, sepse nuk dallojnë nga variantet që i njeh LPP i RM-së.

Personat e autorizuar për të kërkuar rishikimin e procedurës penale janë palët dhe mbrojtësi. Rishikimi i procedurës penale mund të kërkohej edhe pasi i dënuari e mban dënimin, pavarësisht nga afati i parashkrimit, amnistisë ose faljes.

Gjykata me aktvendim e hudh kërkesën kur në bazë të saj dhe shkresave të procedurës së mëparshme vërteton se:

- 1) Kërkesën e ka parashtruar personi i paautorizuar;
- 2) Nuk ka bazë ligjore për rishikim të procedurës;
- 3) Faktet dhe provat në të cilat mbështetet kërkesa janë paraqitur në kërkesën e mëparshme për rishikim të procedurës e cila është refuzuar me aktvendim të formës së prerë;
- 4) Faktet dhe provat nuk ofrojnë arsye për lejim të rishikimit të procedurës;
- 5) Parashtruesi i kërkesës për rishikim të procedurës penale nuk ka vepruar sipas nenit 425, pragrafi 2, të KPPRK;⁵⁴

Kur gjykata nuk e hudh kërkesën, kopja e kërkesës i dërgohet prokurorit të shtetit ose palës kundërshtare, e cila ka të drejtë që brenda tetë (8) ditëve të përgjigjet në kërkesë. Pasi gjykata merr përgjigje në kërkesë ose

⁵³ Buletini i Odës së Avokatëve të Kosovës "Avokatura", viti VIII, nr.14/2012, fq. 51

⁵⁴ Neni 426, paragrafi 1, KPPRK, Nr. 04/L-123

kur kalon afati për përgjigje, kryetari i kolegjit urdhëron gjurmimin dhe shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura në kërkesë dhe në përgjigje.⁵⁵

Bazuar në rezultatet e hetimit, gjykata e **aprovon kërkesën dhe lejon rishikimin e procedurës penale ose e refuzon kërkesën.**

4.1.4.2. Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit

Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit lejohet kur pas formës së prerë të aktgjykimit paraqiten rrethana të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose, megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë, gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato rrethana dukshëm do të ndikonin në dënim më të ulët.⁵⁶

Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund të paraqitet vetëm në dobi të të pandehurit. Me kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit kërkohet që aktgjykimi i formës së prerë të ndryshohet për sa i përket vendimit lidhur me dënimin.⁵⁷

Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund të paraqes prokurori i shtetit kur procedura është zbatuar me kërkesë të tij, i dënuari dhe mbrojtësi i tij. Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk e pezullon ekzekutimin e dënimit.

Për kërkesën mbi zbutje të jashtëzakonshme të dënimit vendos **Gjykata Supreme e Kosovës**.⁵⁸ Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit duhet të përmbajë të gjitha elementet e parapara me kodin e procedurës penale, si dhe i paraqitet gjykatës themelore e cila e ka marrë aktgjykimin. Gjykata themelore ia dërgon kërkesën prokurorit të shtetit, i cili përgjigjet në kërkesën për mjet juridik.

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues të gjykatës themelore e hudh kërkesën që nuk është në pajtim me nenin 376 të KPPRK. Gjykata themelore vërteton se a ekzistojnë shkaqe për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, e pastaj shkresat me propozimin e arsyetuar ia dërgon Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës refuzon kërkesën kur çmon se nuk ka bazë ligjore për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit. Kur e aprovon kërkesën, gjykata me aktvendim e ndryshon aktgjykimin e formës së prerë lidhur me vendimin mbi dënimin.

⁵⁵ Neni 426, paragrafi 2, KPPRK, Nr. 04/L-123

⁵⁶ Neni 429, KPPRK, Nr. 04/L-123

⁵⁷ Sahiti, Ejup, E drejta e procedurale penale, Prishtinë, 2005, fq.244

⁵⁸ Neni 431, paragrafi 1, KPPRK, Nr. 04/L-123

4.1.4.3. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është mjet i jashtëzakonshëm juridik, qëllimi i të cilit është të mënjanojnë shkeljet ligjore nga vendimet e plotëfuqishme. Në këtë mënyrë, edhe në bazë të këtij mjeti juridik, zbulohen të gjitha të metat në vendimet gjyqësore të plotëfuqishme dhe ofrohet mundësia për mënjanimin e të njëjtave.⁵⁹

Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në rastet vijuese:

- 1) në rast të shkeljes së ligjit penal;
- 2) në rast të shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale (neni 384, paragrafi 1, KPPRK);
- 3) në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor;

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike.⁶⁰

Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqesë Kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, dhe personat tjerë të paraparë në KPPRK, mund të paraqesin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë Brenda tre (3) muajve nga dita kur të pandehurit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i formës së prerë, nëse kundër vendimit të gjykatës themelore nuk paraqitet ankesë, afati rrjedh nga dita kur vendimi merr formë të prerë.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë i paraqitet gjykatës themelore që ka marrë vendimin. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i gjykatës themelore me aktvendim e hudh kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nëse: kërkesa është paraqitur kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kërkesa është paraqitur nga personi i paautorizuar ose kërkesa është paraqitur jashtë afatit. Kundër aktvendimit mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit.

Varësisht nga përmbajtja e ankesës, gjykata themelore mund të vendos që ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë të shtyhet apo të ndërpritet. Me rastin e vendosjeje mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon.

⁵⁹ Buletini i Odës së Avokatëve të Kosovës “Avokatura”, viti VIII, nr.14?2012, fq. 51

⁶⁰ Neni 432, paragrafi 2, KPPRK, Nr. 04/L-123

4.1.5. Krahاسimi i procedurës lidhur me mjetet juridike Maqedoni-Kosovë

Duke e krahasuar procedurën lidhur me mjetet juridike në mes Maqedonisë dhe Kosovës, shohim se nuk ka ndonjë dallim thelbësor. Janë thuajse të njëjtat gjëra që përsëriten në LPP të RM-së dhe në KPPRK.

Duke filluar nga **mjetet e rregullta juridike**, në bazë të LPP të RM-së, mjete të rregullta juridike janë: ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë, ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së dytë dhe ankesa në aktvendim.

Gjithashtu edhe në bazë të KPPRK si mjete të rregullta juridike janë: ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit si dhe ankesa kundër aktvendimit. Pra këtu vërejmë se nuk ka asnjë dallim ndërmjet mjeteve të rregullta juridike në Maqedoni dhe në Kosovë, gjithashtu edhe afatet për paraqitjen e mjeteve juridike janë të njëjta në mes LPP dhe KPPRK, personat e autorizuar për të paraqitur mjet juridik janë të njëjtë si dhe zhvillimi i procedurës në gjykatën më të lartë është i njëjtë.

Sa u përket **mjeteve të jashtëzakonshme juridike**, në bazë të LPP janë: **rishikimi (përsëritja) e procedurës penale, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm aktgjykimit të formës së prerë.**

Në bazë të **KPPRK** mjete të jashtëzakonshme juridike janë: **rishikimi i procedurës penale, zbutja e jashtëzakonshme e dënimit, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.**

Te mjetet e jashtëzakonshme juridike ka disa dallime të vogla, në procedurën penale të Kosovës parashihet mjeti juridik i zbutjes së dënimit, që në procedurën penale të Maqedonisë më ndryshimet në LPP, ai mjet juridik është hequr, si mjet juridik që është në procedure penale të Maqedonisë, por që mungon në procedurën penale të Kosovës është kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm.

Dallim tjetër ekziston edhe tek kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, në bazë të LPP të RM-së si person i autorizuar për të paraqitur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë është vetëm prokurori publik i Republikës së Maqedonisë, ndërsa në procedurën penale të Kosovës, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë përveç Kryeprokurorit të Shtetit, mundet ta paraqesën edhe i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Edhe te mjetet e jashtëzakonshme juridike afatet për të paraqitur mjet juridik janë të njëjta, nuk ka dallime në mes LPP dhe KPPRK, gjithashtu edhe procedura zhvillohet gati se e njëjtë para gjykatave më të larta. Edhe në procedurën penale të Kosovës njëjtë si në procedurën penale të Maqedonisë, gjatë përdorimit të mjetit juridik, mjeti juridik paraqitet në gjykatën që e ka marrë aktgjykimin në shkallë të parë, që nënkupton në gjykatën themelore.

4.2. Mjetet juridike në bazë të Kodit të Porcedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

Ligji përcakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhërat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e ankimit.

Mjetet e ankimit në bazë të KPPSH, janë:

- 1) Apeli**
- 2) Rekursi në Gjykatën e Lartë**
- 3) Kërkesa për rishikim**

Këto mjete juridike edhe pse të përbashkët e kanë qëllimin e ankimit, por dallojnë njëra prej tjetrës, edhe atë:

Nga lloji i vendimit që ankimohet. Në rastin e apelit kundërshtohet vendimi përfundimtar i gjykatës së shkallës së parë ose çdo vendim vendim tjetër për të cilin ligji parashikon mundësinë e ankimit. Në rastin e rekursit ankimohet vendimi i formës së prerë i gjykatës së shkallës së parë që nuk është ankimuar në afat ose vendimi i gjykatës së apelit që ka shqyrtuar ankimin kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Nga shkaqet e ankimit. Në rastin e ankimit në gjykatën e apelit nuk ka asnjë kufizim për shkaqet e ankimit. Rekursi në Gjykatën e Lartë mund të bëhet vetëm për shkaqe ligjore të parashikuara në nenin 432 i KPPSH. Kërkesa për rishikim mund të bëhet vetëm për shkaqet e parashikuara nga neni 450 i KPPSH.

Nga gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit. Apeli i drejtohet gjykatës së apelit, kurse rekursi, Gjykatës së Lartë, Kërkesa për rishikim i drejtohet Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë e prish vendimin dhe e dërgon çështjen për shqyrtim në gjykatën që ka dhënë vendimin e prishur.

Nga afati i paraqitjes së ankimit. Ankimi në gjykatën e apelit mund të bëhet Brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Rekursi në Gjykatën e Lartë mund të bëhet brenda 30 ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, në shkallë të parë ose në shkallë të dytë.⁶¹

Akti i ankimit bëhet me shkrim dhe paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin e ankimuar. Ai merret në dorëzim nga sekretari i gjykatës, i cili shënon sipër aktit ditën e dorëzimit dhe personin që e ka paraqitur.

⁶¹ ISLAMI, Halim. HOXHA, Artan. PANDA, Iir. Procedura Penale, Tiranë. 2003, fq. 543

4.2.1. Apeli

Prokurori, i pandehuri dhe palët private mund të apelojnë vendimet e gjykatës së shkallës së parë. Mbi apelin e bërë kundër vendimeve të gjykatës së rrethit gjyqësor vendos gjykata e apelit.⁶² Për ankimin e bërë kundër vendimeve të gjykatës për krime të rënda vendos gjykata e apelit për krimet e rënda.

Gjykata e apelit e shqyrton çështjen në tërësi dhe nuk kufizohet vetëm në shkaqet e paraqitura në ankim. Ajo shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtepandehurve që nuk kanë bërë ankim brenda kufijve që referojnë shkaqet e ngritura bë ankim.⁶³

Kur apelues është **prokurori**, gjykata e apelit:

- a) Mund t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë, të ndryshojë llojin ose ta rrisë masën e dënimit, të ndryshojë masat e sigurimit dhe të marrë çdo masë tjetër që urdhëron apo lejon ligji;
- b) Mund t'i japë dënim atij që është deklaruar i pafajshëm, t'i japë pafajësi për një shkak të ndryshëm nga ai që pranohet në vendimin e apeluar;
- c) Mund të zbatojë, të ndryshojë ose të përjashtojë dënimet plotësuese dhe masat e sigurimit.

Kur apelues është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar. Është e vertetë që me ankimin e tij të pandehurit nuk mund t'i përkeqësohet pozita, por ky parim shërben si garanci kur mjetin e ankimit e ka përdorur i pandehuri dhe nuk mund të shërbejë si i tillë kur mjetin e ankimit e ka përdorur prokurori.

Kryetari i kolegjit të gjykatës së apelit urdhëron thirrjen e të pandehurit, paditësit civil dhe të padituri civil, si dhe të mbrojtësve e të përfaqësuesve të tyre. Afati i paraqitjes nuk mund të jetë më i vogël se dhjetë ditë. Urdhëri i thirjes dhe njoftimet duhet të jenë të plota dhe të sakta, sidomos lidhur me identitetin e të pandehurit dhe kohën e paraqitjes. Kur i pandehuri nuk është identifikuar në mënyrë të sigurt ose kur në thirrje nuk është saktësuar vendi, dita dhe ora e paraqitjes, njoftimi është i pavlefshëm, dhe për pasojë, seanca shtyhet.⁶⁴

Gjykata e apelit, pasi shqyrton çështjen, i merr këto vendime:

- a) lëniën në fuqi të vendimit;
- b) ndryshimin e vendimit;

⁶² Neni 424, paragrafi 1, KPPSH

⁶³ Neni 425, paragrafi 1, KPPSH

⁶⁴ ISLAMI, Halim. HOXHA, Artan. PANDA, Iir. Procedura Penale, Tiranë. 2003, fq. 551

- c) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes kur janë rastet që nuk lejojnë fillimin ose vazhdimin e procedimit ose kur vërtetohet fajësia e të pandehurit;
- d) prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar ose ndihmësgjyqtar në çështjen konkrete, me numrin e gjyqtarëve dhe ndihmësgjyqtarëve që është i domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara, me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, me pjesëmarrjes së përfaqësuesit të të dëmtuarit akuzues dhe të mbrojtësit të të pandehurit, me shkeljen e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja, si dhe në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit.

4.2.2. Rekursi në Gjykatën e Lartë

Rekursi është mjet juridik i paraparë në KPPSH, më të cilin akimohen vendimet e gjykatës së apelit. Janë objekt rekursi të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë vendimet e gjykatës për mosmarrëveshjet me juridiksionin dhe kompetencat si dhe rastet e parashikuara me ligj,

Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe:

- a) për mosrespektim ose për zbatim të gabuar të ligjit penal;
- b) për shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të KPPSH;
- c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.⁶⁵

Rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji. Mospranimi i rekursit vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Rekursi duhet të paraqitet në afat prej tridhjetë ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë. Ai duhet të përmbajë tregimin e saktë të shkaqeve të paligjshmërisë së vendimit

Kryetari i Gjykatës së Lartë cakton kolegjet përkatëse për rishqyrtimin e rekurseve, gjitashtu cakton datën për shqyrtim të rekursit. Gjykata e Lartë gjykon në kolegji me pesë gjyqtarë. I pandehuri dhe palët private përfaqësohen nga mbrojtësit.⁶⁶

Vendimi meret menjëherë pas mbarimit të seancës dhe shpallet në seancë, duke u lexuar nga kryetari ose një gjyqtarë, por kur çështja paraqitet e ndërlikuar ose ka rëndësi të veçantë, kryetari i kolegjit mund ta shtyjë marrjen e vendimit për aq ditë sa është e nevojshme.

⁶⁵ Neni 432, KPPSH

⁶⁶ Neni 437, paragrafi 1, 2, KPPSH

Në bazë të nenit 441, Kolegji Penal ose kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin:

- a) lënien në fuqi të vendimit ndaj të cilit është bërë rekurs;
- b) ndryshimin e vendimit për cilësimin ligjor të veprës, për llojin dhe masën e dënimit, për pasojat civile të veprës penale;
- c) prishjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim;
- d) prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rishqyrtim;
- e) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.⁶⁷

Gjykata e Lartë vendos prishjen e vendimit dhe zgjidhjen çështjes pa e kthyer në rishqyrtim kur:

- a) fakti nuk parashikohet si vepër penale, vepra penale është shuar ose ndjekja penale nuk duhet të fillonte e të vazhdonte;
- b) vendimi është i pavlefshëm për rastet e parashikuara në KPPSH;
- c) vendimi është dhënë me gabim në person;
- d) ka kontradikta në mes vendimit të ankimuar dhe një tjetri të mëpërashëm, lidhur me të njëjtin person dhe me të njëjtën vepër penale, të dhëna nga e njëjta ose një tjetër gjykatë penale.⁶⁸

Prishja e vendimit vlen edhe për të pandehurin që nuk ka bërë ankim, me përjashtim të rastit kur shkak i prishjes është personal për atë që ka bërë rekursin. Kështu mund të ndodhë kur i pandehuri që ka bërë ankim ka parashtruar shkaqe që lidhen me moshën, gjendjen shëndetësore, familjare, etj.⁶⁹

Vendimi i ankimuar mund të priset në tërësi ose për pjesë të veçanta të tija. Në dispozitivin e vendimit të Gjykatës së Lartë tregohen qartë cilat pjesë të vendimit prishen. Kështu veprohet, përsëmbull, kur vendimi priset për njërën nga akuzat që i është bërë të pandehurit, kur duhet sqaruar cilësimi juridik i njëres nga veprat penale, etj. Por, kur vendimi priset vetëm për disponimet ose pikat që kanë të bëjnë me padinë civile, Gjykata e Lartë ia dërgon aktet gjykatës civile që është kompetente për gjykimin e padisë civile.⁷⁰

Kur vendos prishjen e vendimit të ankimuar, Gjykata e Lartë ia dërgon aktet gjykatës që ka dhënë vendimin e prishur, sipas rastit, gjykatës së shkallës së parë ose gjykatës së apelit. Në qoftë se prishen vendimet e të dy shkallëve, atëher aktet i dërgohen gjykatës së shkallës së parë. Kur del që ka kontradikta midis vendimit të ankimuar dhe një tjetri të mëparshëm, lidhur me të njëjtin person dhe të njëjtën vepër penale, Gjykata e Lartë zbaton vendimin që ka dënim më pak të rëndë.

⁶⁷ Neni 441, KPPSH

⁶⁸ Neni 443, KPPSH

⁶⁹ ISLAMI, Halim. HOXHA, Artan. PANDA, Iir. Procedura Penale, Tiranë. 2003, fq. 574

⁷⁰ Po aty, fq. 575

4.2.3. Rishikimi

Rishikimi i vendimeve është një mjet i jashtëzakonshëm juridik për goditjen e vendimeve penale të formës së prerë.

Në kuptimin e gjërë, me rishikim nënkuptohet shqyrtimi edhe një herë i çështjeve gjyqësore të përfunduara me vendim të formës së prerë me qëllim modifikimi ose shfuqizimi. Si rregull, ai bëhet për shkaqe të caktuara, të lidhura me bazueshmërinë e vendimit.⁷¹

Vendimet e pafajësisë për krime mund të rishikohen me kërkesën e prokurorit, por me kusht që të mos ken kaluar pesë (5) vjet nga dhënia e dënimit.

Rishikimi mund të kërkohej në këto raste:

- a) kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë;
- b) kur vendimi është i bazuar në një vendim të gjykatës civile, i cili është revokuar më pas;
- c) kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar;
- d) kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale.⁷²

Kërkesën për rishikim mund të kërkojnë: i dënauari ose kujdestari i tij, dhe kur ai ka vdekur, trashëgimtari ose një i afërm i tij si dhe prokurori pranë gjykatës që e ka dhënë vendimin. Kërkesa për rishikim bëhet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit, ajo duhet të përmbajë provat që e përligjin dhe duhet të paraqitet, bashkë me dokumentet eventuale, në sekretarinë e Gjykatës së Lartë.

Kërkesa e rishikimit shqyrtohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve. Kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara me nenin 450, të KPPSH, ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë ose kur rezulton haptazi e pambështetur, Kolegji Penal vendos mospranimin e saj.

Kur kërkesa për rishikim pranohet, Kolegji Penal vendos prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim nga një tjetër trup gjykues në gjykatën e shkallës së parë që e ka dhënë vendimin ose në gjykatën e apelit, kur kërkesa është bërë vetëm kundër vendimit të saj. Vendimi është i formës së prerë.

Gjykimi i çështjes për rishikimin e vendimit nga gjykata e caktuar në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, bëhet në përputhje me rregullat e caktuara për gjykimin e shkallës së parë. Por kuptohet që ai

⁷¹ Po aty, fq. 581

⁷² Neni 450, KPPSH

përqëndrohet në shkaqet e parashtruara në kërkesën e rishikimit, duke u marrë e verifikuar provat që vërtetojnë se vendimi është i gabuar. Nuk mund të jepet vendim vetëm duke bërë vlerësim tjetër të provave të marra në gjykimin e mëparshëm.⁷³

Kur rëzohet kërkesa, gjykata detyron atë që e ka bërë me shpenzimet procedurale dhe kur është urdhëruar pezullimi, vendos rivënien në ekzekutim të dënimit ose të masës së sigurimit. Me kërkesën e të interesuarit, vendimi i pafajësisë afishohet i shkurtuar në rrethin ku është dhënë vendimi dhe në vendbanimin e fundit të të dënuarit. Kryetari i gjykatës mund të urdhërojë që ky vendim të shpallet në një gazetë të caktuar.

Pasi vendimi të ketë marrë formën e prerë, ai që është deklaruar i pafajshëm, gjatë rishikimit ka të drejtë për një **kompensim në përpjestim me kohëzgjatjen e dënimit** dhe me pasojat personale e familjare që rrjedhin nga dënimi. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe trashëgimtarët e të dënuarit, kur ai ka vdekur, qoftë edhe para procedimit të rishikimit, me përjashtim të trashëgimtarëve të padenjë.⁷⁴

Të drejtën e kompensimit nuk e përfitojnë të dënuarit që me dashje ose nga pakujdesia e rëndë, kanë dhënë shkak për gabim gjyqësor. i tillë mund të jetë rasti kur i gjykuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është dënuar me qëllim që të mbulonte një vepër tjetër ose nuk ka treguar provat që e shfajësonin ose lehtësonin përgjegjësinë penale për të shpëtuar një tjetër, ose ka neglizhuar paraqitjen në afat të ankimit dhe për pasojë, çështja nuk është gjykuar nga gjykata e apelit.⁷⁵

Kërkesa për kompensim duhet të bëhet brenda dy viteve nga data që vendimi i rishikimit ka marrë formë të prerë, përndryshe nuk pranohet. Ajo paraqitet në sekretarinë e gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin. Kërkesa për kompensim shqyrtohet në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve.

Kur gjykata pranon kërkesën për kompensim, në këtë rast gjykata vendos edhe për masën dhe llojin e kompensimit që do të bëhet. Kompensimi bëhet me pagimin e një shumë parash ose me dhëniën e një të ardhure jetësore, siç mund të jetë pagimi i një pensioni mujor të caktuar. Në të dyja rastet kompensimi duhet t'i përgjigjet kohëzgjatjes së dënimit dhe pasojave të tjera që kanë ardhur nga vuajtja e dënimit, si dëmtimi i shëndetit, pakësimi i aftësive për të punuar, etj.⁷⁶

Mospranimi i kërkesës ose vendimi që e rrëzon atë nuk cënon të drejtën e paraqitjes së një kërkesë të re për rishikim e cila bazohet në prova apo fakte të reja.

Kërkesa i komunikohet prokurorit dhe të gjithë të interesuarve. Kundër vendimit për kompensim mund të bëhet ankim.

⁷³ Neni 456, paragrafi 1 dhe 2, KPPSH

⁷⁴ ISLAMI, Halim. HOXHA, Artan. PANDA, Iir. Procedura Penale, Tiranë. 2003, fq. 590

⁷⁵ Po aty, fq.590

⁷⁶ Po aty, fq. 591

4.2.4. Krahاسimi i procedurës lidhur me mjetet juridike Maqedoni-Shqipëri

Me anë të metodës së krahasimit do të nxjerrim në pah dallimet që ekzistojnë në mes procedurës penale të Maqedonisë dhe të procedurës penale të Shqipërisë.

Duke e krahasuar procedurën me mjetet juridike të Maqedonisë dhe të Shqipërisë konstatojmë se nuk ekziston ndonjë dallim shumë i madh ndërmjet mjeteve juridike, por është formulimi që i bëhet në LPP të Maqedonisë dhe në KPP të Shqipërisë.

Ashtu siç parashihet në LPP ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, njëjtë është edhe apeli në KPPSH, pra formulimi është ai që i dallon këto dy mjetet juridike, sepse në esencë nuk dallojnë, për shkak se qëllimi është i njëjtë, pra goditet vendimi i gjykatës së shkallës së parë, respektivisht apelohej vendimi.

Në LPP të Maqedonisë parashihet ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, ndërsa në KPP të Shqipërisë parashihet rekursi në Gjykatën e Lartë, që në esencë janë të njëjta por që dallojnë te arsyet e paraqitjes. Rekursi mund të paraqitet vetëm për gabimet e natyrës ligjore, ndërsa në bazë të LPP ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë mund të paraqitet kur është shqiptuar dënim me burgim të përjetshëm ose është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë me të cilin është shqiptuar dënim i tillë.

Në LPP të Maqedonisë është paraparë edhe ankesa kundër aktvendimit, mjet juridik i cili nuk është i paraparë në KPP të Shqipërisë.

Te mjetet e jashtëzakonshme juridike, në bazë të LPP kemi kërkesën për përsëritje të procedurës penale, ndërsa te KPPSH kemi kërkesën për rishikim, që në parim dyjat kërkojnë përsëritjen e procedurës penale. Ashtu siç është në LPP, njëjtë edhe në KPPSH baza e këtij mjeti juridik qëndron te gabimet e natyrës faktike. Pra kur gjatë procedurës penale mund të kishin ndodhur gabime gjatë vërtetimit të gjendjes faktike, atëherë kjo paraqet bazë për të pandehurin që të paraqet kërkesë për përsëritje, përkatësisht rishikim të procedurës penale.

Si mjete juridike që nuk janë të parapara në KPPSH janë: kërkesa për mbrojtje të ligshmërisë dhe kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të formës së prerë. Duke pasur parasysh afatet për paraqitjen e mjeteve juridike, në krahasim me afatet që janë të parapara në LPP të RM-së, në parim në bazë të KPPSH, afatet janë më të gjata se sa në procedurën penale të Maqedonisë. Dallim tjetër është se në bazë të KPPSH, kemi edhe Gjykatë Apeli për krime të rënda, ndërkajë te nuk ka kështu ndarje, pra janë gjykatat e apelit ato që gjykojnë në shkallë të dytë.

KAPITULLI V

5. Analizimi i rasteve konkrete

Një kapitull të veçantë ia kam kushtuar lëndëve penale konkrete të marra nga Gjykata Themelore e Tetovës, si dhe nga portali i gjykatave të RM-së, ku publikohen lëndët dhe vendimet e marra nga ana e gjykatave në RM. Këtu do të analizojmë të gjitha mjetet juridike në praktikë, për secilin mjet juridik do të paraqesë vendimin e gjykatës kompetente, mjetin juridik me të cilin është goditur ai vendim, si dhe vendimin e gjykatës në bazë të mjetit juridik. Nuk do të paraqiten të gjitha pjesët e aktgjykimit, por do të paraqesim veprën penale për të cilën i pandehuri shpallet fajtor, nenet e Kodit Penal në të cilat mbështetet aktgjykimi, ankesën e palëve kundrejt aktgjykimit, bazat (arsyet) e ankesës, dhe aktgjykimi i gjykatës më të lartë. Së pari do të fillojmë me mjetet e rregullta juridike, e më pas më mjetet e jashtëzakonshme. Të akuzuarit do të shkruhen vetëm më shkronja, **për shembull i akuzuari A.B**, për shkak të ruajtjes së privatësisë së të akuzuarve. Do të shkruhet edhe numri i lëndëve.

5.1. Ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë

Në fillim do të paraqesim **aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë**.

Në emër të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë

K-560/16

Gjykata Themelore Tetovë, si gjykatë e shkallës së parë, me gjykatës A.A, si gjykatës i vetëm, dhe procesmbajtësin A.B, në lëndën penale kundër të pandehuritt A.C, për vepër penale **MUNDËSIM I PËRDORIMIT TË DROGAVE NARKOTIKE**, në bazë të nenit 216, paragrafi 1, i KP, pas propozim akuzës nga Prokurori Themelore Publike Tetovë, pas shqyrtimit gjyqësor, e solli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari, A.C, i lindur më 01.01.2000, shpallet:

FAJTOR

Sepse, me datë 01.11.2015, në orën 10:30, në Burgun e Tetovës, vllaut të tij i ka dhënë substancë narkotike e llojit mariuhanë, me masë 2.15 gram, në mënyrë që vllau i të akuzuarit e ka vuajtur dënimin më burg, i akuzuari ka ardhë dhë në zyrën e pranimit ka lënë një xhaketë për vllaun e tij dhe është larguar, pas kontrollit që është bërë nga ana e nëpunësve është gjetur substanca narkotike e llojit mariuhanë në masën e lartëshënuar.

Në bazë të nenit 216, paragrafi 1, i KP, gjykata shqipton masë alternative:

DËNIM ME KUSHT

Vërtetohet dënimi me burgim prej 9 muajsh, i cili dënimi nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej 2-dy vitesh nuk kryen vepër të re penale.

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 8- tetë ditësh.

Në aktgjykim janë të përshkruar edhe si ka rrjedhur shqyrtimi gjyqësor, por tash nuk na nevojitet ajo, na intereson me shumë përdorimi i ankesës. Më poshtë do të paraqesim ankesën të cilën e ka paraqitur **PROKURORI PUBLIK nga Prokuroria Themelore Publike** deri në Gjykatën e Apelit Gostivar.

Prokuroria Themelore Publike

Nëpërmjet : Gjykatës Themelore - Tetovë

IV.KO. 286/16, Tetovë

Deri te: Gjykata e Apelit – Gostivar

ANKESË

Kundër: Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Tetovës K-560/16

Baza Vendimi për sanksion penal- Neni 414, paragrafi 4, LPP

Prokurori publik pas pranimit të aktgjykykimit të lëndës, të njëjtën e apelon vetëm për një arsye, edhe atë për shkak të: vendimit për sanksion penale në bazë të nenit 414, paragrafi 4, i LPP-së.

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, por kur ka bërë matjen e dënimit, Gjykata në rastin konkret, nuk e ka llogaritur në bazë të Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit.⁷⁷

Gjatë matjes së lartësisë së dënimit dhe vërtetimit të rethanave lehtësuese dhe të rethanave rënduese të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit, i ka vërtetuar vetëm rethanat lehtësuese, ndërkaj për rastin konkret nuk llogaritur asnjë rethanë rënduese.⁷⁸

Duke pasur parasysh gabimet gjatë llogaritjes së dënimit, Gjykata nuk është dashur të shqiptojë **DËNIM ME KUSHT**, por konstatojmë se në rastin konkret të pandehurit është dashur t'i shqiptohet dënimi me

⁷⁷ Ligji për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, nuk është më i zbatueshëm në sistemin penal të RM-së, por meqë lënda penale është më e vjetër, do e shkruajmë ashtu siç është. Këtë ligj e abrogoi Gjykata Kushtetuese e RM-së, dhe tani si bazë për shqiptimin e dënimit mbetet vetëm lartësia e dënimeve që është përcaktuar në Kodin Penal të RM-së. Ishte absurde që të kemi një ligj të tillë, kur në Kodin Penal në mënyrë të qartë janë të parapara dënimet për secilën vepër penale.

⁷⁸ Në ankesë janë të paraqitura edhe pikët që kanë shërbejt si rethana lehtësuese.

burgim efektiv, që të arrihen qëllimet e dënimit, në drejtim të prevenimit special dhe gjeneral, dhe për këtë vepër penale në qoftë se kemi dënim me kusht, nuk do të arrihen qëllimet e dënimit, dhe për këtë Gjykatës së Apelit Gostivar, i

PROPOZOJ

Ankesën e PTHP- Tetovë, **TA PRANOJË**, a ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore-Tetovë, **TAN DRYSHOJË**, në pjesën e vendimit për sanksion penal, dhe të pandehurit për veprën e kryer penale t'i shqiptojë dënim adekuat me burgim efektiv.

PROKURORI PUBLIK

B.B

Më poshtë do të sjellim aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Gostivar.

KZH. 322/16

Në emër të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë

Gjykata e Apelit Gostivar, në kolegji i përbërë nga gjykatësit, A.F, kryetar i kolegjit, dhe anëtarët, B.J dhe K.B, dhe procesmbajtësin A.J, në lëndën penale kundër të pandehurit A.C, për veprën penale Mundësim i përdorimit të substancave narkotike, në bazë të nenit 216, paragrafi 1, i KP, duke vepruar në bazë të ankesës nga PTHP- Tetovë, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Tetovë, sjell këtë:

AKTGJYKIM

ANKESA e Prokurorisë Themelore Publike, **PRANOHET**

AKTGJYKIMI i Gjykatës Themelore Tetovë, me numër K.560/16, **NDRYSHOHET** vetëm në pjesën e vendimit për sanksion penal, ashtu që i pandehuri A.C, nga Tetova, i cili me aktgjykimin e shkallës së parë është shpallur i fajshëm për kryerjen e veprës penale Mundësim i përdorimit të substancave narkotike, në bazë të nenit 216, paragrafi 1, KP, në pajtim me këtë nen dhe dispozitat e neneve 4, 32, 33, 34 dhe 35 të Kodit Penal, **DËNOHET** me dënim me burg prej 9 (nëntë) muajsh.

Në pjesën tjetër aktgjykimi i shkallës së parë, **VËRTETOHET**.

ARSYETIM

Në bazë të aktgjykimit të shkallës së parë, të pandehurit i është shqiptuar dënim me kusht, nëse si gjykatë konstatojmë se ai dënim nuk i përmbush qëllimet e dënimit dhe nuk do të ndikojë te i pandehuri që të mos e

përsëris veprën penale në të ardhmen. Dënimi i cili i jepet me këtë aktgjykim të shkallës së dytë do i përmbush qëllimet e dënimit në drejtim të preventimit special dhe gjeneral.

GJYKATA E APELIT GOSTIVAR, KZH. 322/16.

Procesmbajtës

A.J

Kryetar i kolegjit- gjykatës

A.F

Analizimi i lëndës- pra këtu kemi rastin që në praktikë të shohëm se si është goditur aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, dhe vendimin e marrë nga gjykata e shkallës së dytë. Në bazë të aktgjykimeve të shkallës së parë dhe shkallës së dytë, vërejmë se gjykata e shkallës së parë gjatë shqiptimit të dënimit, nuk i ka marrë parasysh të gjitha rethanat rënduese mbi të pandehurim. Dënimi që është paraqitur në aktgjykimin e shkallës së parë, në bazë të mendimit tim, është shumë i lehtë dhe nuk është në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Kodit Penal. Në bazë të nenit 216, paragrafi 1 i Kodit Penal, vepra penale **Mundësim i përdorimit të drogave narkotike**, dënohet me dënim me burgim prej 1 (një) deri në 5 (pesë) vite.

Ne aktgjykimin e shkallës së parë kemi shqiptim të dënimit me kusht, që është shumë i lehtë në krahasim me veprën penale, te vepra penale kemi paramendim të të pandehurit në kryerjen e veprës penale, pra këtu kemi dashje direkte nga i pandehuri, vepra penale nuk është kryer nga pakujdesia që i pandehuri të dënohet me kusht. Pastaj kemi ankesën nga ana e PTHP Tetovë, e cila kërkon nga Gjykata e Apelit Gostivar, që të ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë vetëm në pjesën e sanksionit penal, pra nga dënimi burgim me kusht në dënim efektiv me burg. Këtu bën pjesë edhe njëra ndër arsyet për ankesë që është e paraparë në LPP, pra shkelje të dispozitave të Kodit Penal, gjithashtu në aktgjykim janë cekur edhe dispozitat e Ligjit për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, i cili ligj më nuk është i zbatueshëm në procedurën penale të RM-së, për shkak se është abroguar nga Gjykata Kushtetuese e RM-së.

Dhe tek në fund kemi vendimin e Gjykatës së Apelit Gostivar. Kolegji është i përbërë prej 3 gjykatësve, një kryetar dhe dy antarë. Me aktgjykimin e kësaj gjykate **pranohet** ankesa e PTHP Tetovë dhe ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë, këtu hasim te dispozitat që i kemi cekur gjatë pubimit, njëra është se ankesa pranohet dhe e dyta se bëhet ndryshimi i aktgjykimit. Pra këtu gjykata e shkallës së dytë nuk rikthen për rigjykim lëndën, por vetëm e ndryshon atë në pjesën e sanksionit penal, dhe nga dënim me kusht, shqipton dënim me burgim prej nëntë muajsh. Ky aktgjykim nuk mund të ankimohet, dhe është përfundimtar.⁷⁹

⁷⁹ Ky rast është marrë nga Gjykata Themelore Tetovë

5.2. Ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së dytë

Më poshtë do të paraqes ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së dytë si dhe vendimin e Gjykatës Supreme të RM-së në lidhje me ankesën. Duke pasur parasysh që si ankesa ashtu edhe vendimi i supremes janë shumë voluminoz, për këtë arsye nuk do të paraqes të gjithë ankesën dhe aktgjykimin, por vetëm pikat të cilat neve na interesojnë.

Nëpërmjet: Gjykatës Themelore Strugë

Deri te: Gjykata Supreme e RM-së

ANKESË

Kundër: Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Manastir KZH.688/15, të datës 01.12.2015

Gjykata Themelore Strugë me aktgjykimin K.19/15, të datës 19.06.2015, të pandehurin Z.S, e shpalli të fajshëm, për dy vepra penale Vrasje në bazë të nenit 123, paragrafi 3 i KP, në të cilën i shqiptoi dënim me burgim të përjetshëm dhe për dy vepra penale- Vrasje në bazë të nenit 123 paragrafi 1 në lidhje me nenin 19 të KP, për të cilat i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vjetësh.

Gjykata e Apelit Manastir me aktgjykimin KZH.688/15, të datës 01.12.2015, ankesën e të pandehurit, të dhënë personalisht dhe përmes mbrojtësit I.N, i refuzoi si të pabaza, aktgjykimin e shkallës së parë e ndryshoi vetëm në kualifikimin juridik, në atë që të pandehurin Z.S e shpalli të fajshëm për dy vepra penale Vrsaje- **neni 123, paragrafi 1 i KP** dhe dy vepra penale Vrasje **neni 123, paragrafi 1 në lidhje me nenin 19 të KP**, por në bazë të këtyre neneve, e dënoi me një dënim të vetëm dënim me burgim të përjetshëm. Në pjesën tjetër aktgjykimi nuk ndryshoi.

ARSYETIM

Pas ankesës së paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë, Gjykata e Apelit Manastir mbajti senacë të kolegjit në prezencë të, Prokurorit publik, dhe në mungesë të të pandehurit dhe të mbrojtësit. Në këtë mënyrë janë shkelur dispozitat e procedurës penale, sipas nenit 427, paragrafi 1 i LPP-së, sepse seanca e kolegjit nuk mund të mbahet në mungesë të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Në rastin konkret, gjykata jo vetëm që nuk e ka siguruar prezencën e të pandehurit, por edhe e ka mbajtur seancën në mungesë të tij, që domethënë se në krahasim më palën tjetër e ka sjellë në pozitë të pafavorshme, që domethënë shkelje e parimit të barazisë, e proklamuar më legjislacionin e vendit por edhe me praktikën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.

Në aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë ka shkelje esenciale të dispozitavë të procedurës penale neni 415 LPP, gjendja faktike është vërtetuar gabimisht neni 417 LPP, janë cënuar dispozitat e Kodit Penal në bazë të nenit 416 LPP dhe për shkak të vendimit për sanksion penal që është dënim me burgim të përjetshëm.

PROPOZOJ

Që ankesa të pranohet nga ana e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, si gjykatë më e lartë, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Manastir **KZH.688/15** të shfuqizohet, dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së dytë për rigjykim.

Mbrojtësi i të pandehurit

I.N

Më poshtë do të sjellim në pika të shkurta aktvendimin e Gjykatës Supreme të RM-së.

VKZH.2/2016

GJYKATA SUPREME E RM-SË, në kolegji e përbërë prej Kryetarës së gjykatës L.N- kryetare e kolegjit, dhe gjykatësit J.V, R.K, F.A, XH.S, me procesmbajtës M.T, si gjykatë penale në shkallë të tretë në lëndën kundër të pandehurit Z.S për dy vepra penale- Vrasje, neni 123 paragrafi 1 i KP, dhe dy vepra penale- Vrasje, neni 123 paragrafi 1 në lidhje me nenin 19 të KP, duke vendosur për ankesën e të pandehurit, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit KZH.688/15, në seancën e mbajtur me 16.03.2016, në prezencë të Prokurorit publik të RM-së D.C, i pandehuri Z.S i sjellë nga KPU..., dhe mbrojtësit të tij I.N, e sjelli këtë:

AKTVENDIM

Ankesa e të pandehurit Z.S, nga fshati B..., e paraqitur përmes mbrojtësit I.N, **PRANOHET.**

Në bazë të ankesës dhe sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Manastir KZH.688/15, të datës 01.12.2015, SHFUQIZOHET, dhe lënda kthehet në gjykatën e shkallës së dytë për gjykim dhe vendim të sërishëm.

ARSYETIM

Gjykata Themelore Strugë me aktgjykimin K.19/15, të datës 19.06.2015, të pandehurin Z.S, e shpalli të fajshë, për dy vepra penale Vrasje në bazë të nenit 123, paragrafi 3 i KP, në të cilën i vërtetoi dënim me burgim të përjetshëm dhe për dy vepra penale- Vrasje në bazë të nenit 123 paragrafi 1 në lidhje me nenin 19 të KP, për të cilat i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vjetësh.

Gjykata e Apelit Manastir me aktgjykimin KZH.688/15, të datës 01.12.2015, ankesën e të pandehurit, të dhënë personalisht dhe përmes mbrojtësit I.N, i refuzoi si të pabaza, aktgjykimin e shkallës së parë e ndryshoi vetëm në kualifikimin juridik, në atë që të pandehurin Z.S e shpalli të fajshëm për dy vepra penale Vrsaje- **neni 123, paragrafi 1 i KP** dhe dy vepra penale Vrasje **neni 123, paragrafi 1 në lidhje me nenin 19 të KP**, por në bazë të këtyre neneve, e dënoi me një dënim të vetëm dënim me burgim të përjetshëm. Në pjesën tjetër aktgjykimi nuk ndryshoi.

Pas ankesës së paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë, Gjykata e Apelit Manastir mbajti senacë të kolegjit në prezencë të, Prokurorit publik, dhe në mungesë të të pandehurit dhe të mbrojtësit. Në këtë mënyrë janë shkelur dispozitat e procedurës penale, sipas nenit 427, paragrafi 1 i LPP-së, sepse seanca e kolegjit nuk mund të mbahet në mungesë të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Në rastin konkret, gjykata jo vetëm që nuk e ka siguruar prezencën e të pandehurit, por edhe e ka mbajtur seancën në mungesë të tij, që domethënë se në krahasim më palën tjetër e ka sjellë në pozitë të pafavorshme, që domethënë shkelje e parimit të barazisë, e proklamuar më legjislacionin e vendit por edhe me praktikën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.

Gjykata Supreme e RM-së, në bazë të nenit 422 të LPP-së, me datë 16.03.2016 e cakto dhe mbajti seancën publike në të cilën present ishin Prokurori publik i RM-së D.C, i pandehuri Z.S, mbrojtësi i të pandehurit, I.M.

Në këtë pjesë tregohet si ka rjedhur shqyrtimi para kolegjit, fjalët që i kanë pasur i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe prokurori. Këtë pjesë nuk do e shënojmë, do të dalim drejt te pjesa përfundimtare.

Gjykata Supreme e RM-së pas mbajtjes së seancës dhe pas shqyrtimit të ankesës, aktgjykimit kontestues dhe shkresave nga ana e Prokurorisë, si dhe të dhënat e palëve, pas votimit , vendosi:

ANKESA ËSHTË E BAZUAR

Gjykata Supreme e RM-së, duke i vlerësuar pikat e ankesës, dhe pastaj duke i shqyrtuar dispozitat e procedurës penale për të cilat duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare, vërtetoi se aktgjykimi kontestues përmban lëshime të cilat e bëjnë të papërshtatshëm për shqyrtim dhe shpiejnë në dyshime për vërtetësinë e fakteve prej të cilave varet sjellja e një vendimi të drejtë.

E vendosur në Gjykatën Supreme të RM-së, me datë 16.03.2016 me numër VKZH.2/16

Procesmbajtës

M.T

Kryetar i gjykatës- kolegjit

L.N

Analizimi i rastit- duke e parë rastin të cilin e paraqitëm më sipër, shohim se bëhet fjalë për vepër të rëndë penale. Duke parë veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri si dhe sanksionin që i është shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, sanksion i cili është vërtetuar nga shkalla e dytë, kuptojmë se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore që janë të parapara për të paraqitur ankesë kundër aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së dytë. Në nenin 439 të LPP-së janë të parapara rastet në të cilat mund të paraqitet ankesë kundër aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së dytë, këtu është plotësuar njëri nga ato kushte, pra kemi dënim me burgim të përjetshëm për veprat penale Vrasje, neni 123 paragrafi 1.

Veprat për të cilat akuzohet nga PTHP janë Vrasje- neni 123 paragrafi 1 i cili thotë **më së paku dhjetë (10) vjet burgim ose burgim të përjetshëm do të dënohet personi i cili do ta privojë tjetrin nga jeta në mënyrë mizore apo tinëzare.**

Me aktgjykimin e shkallës së parë i pandehuri Z.S, ishte shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënim me burgim të përjetshëm, për këtë arsye ai dhe mbrojtësi i tij paraqitën ankesë deri te gjykata e shkallës së dytë që në këtë rast është Gjykata e Apelit Manastir.

Por gjatë marrjes së vendimit nga ana e gjykatës së shkallës së dytë ka pasur disa shkelje procedurale që më pas ishin si pika në të cilat mbështetej ankesa e të pandehurit e paraqitur përmes mbrojtësit të tij. Gjatë mbajtjes së seancës në gjykatën e shkallës së dytë në të cilën është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë, nuk kanë qenë prezent as i pandehuri dhe as mbrojtësi i tij. Gjykata e shkallës së dytë është dashur që të sigurojë prezencën e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, që të ju jep mundësinë që edhe ata të paraqesin mbrojtjen , në drejtim të verifikimit të fakteve kontestuese.

Duke pasur parasysh veprën penale për të cilën i pandehuri akuzohet dhe sanksionin penal për të cilën parashihet dënim me burgim të përjetshëm dhe në të cilën parashihet mbrojtje e detyrueshme, gjykata e shkallës së dytë është dashur që ta sigurojë prezencën e të pandehurit. I pandehuri pretendon se ai dhe mbrojtësi i tij nuk janë njoftuar në asnjë mënyrë për mbajtjen e seancës së kolegjit në gjykatën e shkallës së dytë. Në seancë ka qenë i pranishëm vetëm Prokurori publik, i cili në këtë rast ka qenë i privilegjuar në krahasim me palët tjera procedurale. Mbajtja e seancës së mbyllur, pa prezencën e të pandehurit, por vetëm të prokurorit dhe kolegjit paraqet dyshime në qëndrimet e prokurorit të cilat mund t'i kishte shprehur në një seancë të mbyllur.

Mendoj së vendimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë që ta pranojë ankesën dhe lëndën ta kthejë për rigjykim në shkallë të dytë është i drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së.⁸⁰

⁸⁰ Ky rast është marrë nga web faqja ku publikohen vendimet e të gjitha gjykatave në RM, www.sud.mk

5.3. Ankesa kundër aktvendimit

Këtu do të paraqesim ankesën kundër aktvendimit, rasti konkret që do të paraqitet është ankesa kundër aktvendimit me të cilin PTHP, kallëzimin penal e hudh poshtë. Ankesa bëhet kundër aktvendimit të PTHP në Prokurorinë e Lartë Publike.

Nëpërmjet: Prokurorisë Themelore Publike Shkup

Deri të: Prokuroria e Lartë Publike Shkup

ANKESË

Kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore Publike, të datës 28.11.2016.

Prokurori publik A.F, me aktvendimin e marrë e hedhë poshtë kallëzimin penal të paditësit M.N për të paditurit, për fshirje nga Lista e votuesve e RM-së në peridhën prej 21-31 gusht 2016, me çka kan kryer veprën penale “Shkelje e të drejtës zgjedhore” e paraparë në nenin 159, paragrafi 1, i Kodit Penal, me arsyetimin se vepra e paraqitur nuk është vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare.

Në bazë të asaj që Aktvendimi gabimisht e vërteton gjendjen faktike dhe juridike, në kohë e paraqes këtë ankesë, paditësi kërkon nga Prokuroria e lartë publike që ta shfuqizojë Aktvendimin e marrë, dhe në bazë të nenit 26 të Ligjit mbi Prokurorinë Publike, vet ta udhëheq procedurën në bazë të kallëzimit penal, si dhe ta thirrë për përgjegjësi prokurorin publik A.F, për kryerje të detyrës zyrtare në mënyrë të pamatur dhe joprofesionale.

ARSYETIM

Prokurori publik A.F, në mënyrë të pabazuar e ka hedhë poshtë kallëzimin penal të paditësit, duke u bazuar në përgjigjen e KSHZ, për çka gabimisht e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe me atë ka ardhur deri të përfundimet e gabuara për gjendjen juridike të rastit. Domethënë:

1. Nuk është e saktë se paditësi nuk i është përgjigjur thirrjes së KSHZ-së. Pas disa tentimeve të pasuksesshme për paraqitje elektronike, paraqita kallëzim penal.
2. Në të njëjtin drejtim janë edhe anëtarët e KSHZ-aë të cilët në pyetjet e gazetarëve reagojnë kundër kallëzimit penal nga ana ime, citoj “... i propozojmë që t’i padit edhe deputetët sepse ata votuan për këtë ligj...”. pra nëse në të vërtetë ka pasur diçka kontestuese me të dhënat e mija, në vend që të më propozojnë që të padis deputetët, ishin të detyruar t’i verifikojnë të dhënat.
3. Nëse në të vërtetë ka pasur diçka kontestuese në të dhënat e mija, pse KSHZ nuk ofroi as edhe faktin më të vogël se është e vërtetë. KSHZ ka mundur që të më vendosin në listën e posaçme nga

lista e votuesve ashtu siç është e paraprë me nenin 196-a të Kodit Zgjedhor. KSHZ në rastin tim jo vetëm që ka pasur shkresë (i prokurorit), por edhe vet i janë përgjigjur asaj shkrese.

4. Arsyet e këtij veprimi nga ana e KSHZ-së, mund të gjenden në faktin se unë kam qenë e zëshme që KSHZ të pastrojë listën zgjedhore në mënyrë serioze. Dukë parë faktin se jam vendosur në listën e votuesve kontestues, del se kjo është bërë me qëllim që të jem e “dënuar”, por edhe në marrjen e të drejtës përmarrje pjesë në zgjedhje.
5. Gabimi katastrofal i prokurorit është se nuk e ka lëxuar deri në fund nenin 196-b të Kodit Zgjedhor dhe nuk ka e ka ndërlidhur me nenin paraprak, 196-a. domethënë të dy nenet nuk parashohin fshirje nga lista e zgjedhore.

Nëse jam fshirë nga lista zgjedhore adon të thotë se jam fshirë edhe nga lista e Drejtorisë së të Hyrave Publike? Nëse PTHP vërteton se nuk duhet të paguaj edhe tatim, atëher pajtohem që KSHZ nuk ka kryer vepër penale, në të kundërtën ata kanë kryer vepër penale me të cilat une kam detyrim, por nuk kam të drejtën e votës.Me këtë kërkoj nga Prokuroria e lartë publike që ta pranojë Kallzëmin penal, në të cilat akuza qëndroë, që të procedohet më tutje.⁸¹

14.12.2016

Paraqitës i ankesës

M.N

Analizimi i lëndës- në kët rast konkret kemi përdorimin e mjetit juridik **ANKESË KUNDËR AKTVENDIMIT**, pra ashtu siç është cekur edhe më lartë, ankesa është paraqitur kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore Publike më të cilin është hedhur poshtë kallëzimi penal i paraqitur nga ana e një qytetari. Nëse prokurori publik vlerëson se vepra e paraqitur nuk paraqet vepër penale atëher me aktvendim e hedhë poshtë kallëzimin penal. Në aktvendimin e dhënë nga prokurori publik shënohet se ka të drejtë ankese kundër aktvendimit në afat prej tetë ditësh deri te prokurori më i lartë publik. Prokurori i lartë publik duhet të vendos në afat prej 30 ditësh nga pranimi i saj. Duke analizuar rastin konkret, shohim që paditësi pretendon se i është shkelur e drejta zgjedhore nga ana e antërëve të KSHZ, që bazohet në nenin 159, paragrafi 1, i Kodit Penal. Gjatë pastrimit të listës zgjedhore nga ana e KSHZ-së, M.N është fshirë nga lista, dhe pretendon se kjo i është bërë me qëllim nga ana e anëtarëve të KSHZ-së, veprim të cilin M.N e paraqet edhe një lloj dënimi për të nga ana e KSHZ.

⁸¹ <http://kvadraturanakrugot.crnaovca.mk/2016/12/14/zhalba-na-reshenieto-na-osnovnoto-javno-obvinitelstvo-za-odbivanje-na-krivichnata-prijava-protiv-dik/>

5.4. Përsëritja e procedurës penale

Në vazhdim do të paraqes kërkesën për përsëritje të procedurës penale që është paraqitur nga ana e të dënuarit, si dhe vendimin e kolegjit penal në lidhje me kërkesën.

Deri te: Kolegji Penal i Gjykatës Themelore Shkupi 1

KËRKESË PËR PËRSËRITJE TË PROCEDURËS PENALE

Nga: i dënuari N.D, nga Shkupi, e paraqitur personalisht dhe përmes mbrojtësit të tij M.I, avokat nga Shkupi

Në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore Shkupi 1, me nr 839/05, më 23.09.2005, tashmë i gjykuari në mungesë N.D. është shpallur fajtor për veprën e kryer penale **PRODHIM I PAAUTORIZUAR DHE LËSHIM NË QARKULLIM TË DROGAVE NARKOTIKE, SUBSTANCAVE PSIKOTROPE DHE PREKURSORËVE**, në bazë të nenit 215, paragrafi 1 në ndërlidhje me nenin 45 të Kodit penal, në bazë të cilës është dënuar me dënim më burg në kohëzgjatje prej 5 vjet.

I dënuari N.D, përmes mbrojtësit të tij M.I, avokat nga Shkupi, me këtë kërkesë kërkojmë përsëritje të procedurës penale, sepse vlersojmë se për rastin konkret janë përmbushur kushtet e parapara ligjore, për përsëritje të procedurës penale, duke pasur parasysh faktin se i dënuari është gjykuar në mungesë, duke u mbështetur në nenin 456, paragrafi 1, LPP.

Në bazë të nenin 456, paragrafi, LPP, procedura penale në të cilën ndonjë person është gjykuar në mungesë, a më vonë ka ardhur mundësia që të gjykohet në prezencë të tij, do të përsëritet nëse i gjykuari apo mbrojtësi i tij, do të kërkojnë përsëritje të procedurës. **Duke pasur parasysh këtë nen të LPP, kërkojmë nga kolegji penal i Gjykatës Themelore Shkupi 1, që procedura penale kundër N.D të përsëritet, dhe të gjykohet në prezencë të tij.**

Mbrojtësi i të dënuarit

M.I

Në vijim do të paraqesim aktvendimin e marrë nga kolegji penal i gjykatës.

K. POV. 480/12

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS THEMELORË SHKUPI 1 SHKUP, i përbërë nga kryetari i kolegjit-gjykatës XH.B, dhe anëtarët e kolegjit L.Ç dhe D.A. me procesmbajtës L.P, duke vendosur për kërkesën për përsëritje të procedurës e paraqitur nga i dënuari N.D, përmes mbrojtësit të tij M.I, në seancën e mbajtur me datë 31.10.2012, e solli këtë:

AKTVENDIM

LEJOHET përsëritja e procedurës penale kundër të dënuarit N.D, më numër amë....., i lindur në, në, ku edhe jeton...., me aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës Themelore Shkupi 1, me nr K.839/05, të datës 23.09.2005.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, të anulohet ekzekutimi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore Shkupi 1, me numër K.839/05, të datës 23.09.2005, deri në sjelljen e aktgjykimit të ri.

Menjëher pas plotfuqishmërisë së aktvendimit, të caktohet shyrtrim gjyqësor.

ARSYETIM

Në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore Shkupi 1, me nr 839/05, më 23.09.2005, tashmë i gjykuari në mungesë N.D. është shpallur fajtor për veprën e kryer penale **PRODHIM I PAAUTORIZUAR DHE LËSHIM NË QARKULLIM TË DROGAVE NARKOTIKE, SUBSTANCAVE PSIKOTROPE DHE PREKURSOREVE**, në bazë të nenit 215, paragrafi 1 në ndërlidhje me nenin 45 të Kodit penal, në bazë të cilës është dënuar me dënim më burg në kohëzgjatje prej 5 vjet.

Prokuroria themelore publike Shkup, ka dhënë mendimin KO.1611/04 të datës 20.10.2012, se janë përmushur të gjitha parakushtet për përsëritjen e procedurës penale.

Kolegji penal, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës penale të kësaj gjykatë K.839.05, vërteton së:

KËRKESA ËSHTË E BAZUAR

Në bazë të nenin 456, paragrafi, LPP, procedura penale në të cilën ndonjë person është gjykuar në mungesë, a më vonë ka ardhur mundësia që të gjykohet në prezencë të tij, do të përsëritet nëse i gjykuari apo mbrojtësi i tij, do të kërkojnë përsëritje të procedurës në afat prej 1 viti nga dita kur i dënuari ka kuptuar për aktgjykimin në të cilin është gjykuar në mungesë.

Në rastin konkret tashmë i dënuari N.D, është gjykuar në mungesë, sepse nuk ka qenë i kapshëm për organet e drejtësisë, a tash ka mundësi të gjykohet në prezencë të tij, sepse gjendet në RM, me adresë banimi në, dhe me deklaratën e dhënë më 29.10.2012, duke pasur parasysh se për aktgjykimin në të cilin është dënuar në mungesë ka kuptuar në fillimin e muajit tetor 2012, janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për përsëritje të procedurës penale.

Dukë pasur parasysh nenin 465, paragrafi 1, LPP, Kolegji vendosi shpalljen e këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE SHKUPI 1, SHKUP, K.POV.480/12, MË DATË 31.10.2012

Procesmbajtës

Kryetar i kolegjit- gjykatës

L.P

XH.B

UDHËZIM: Ankesa është e lejuar ne afat prej 3 ditësh nga pranimi i aktvendimit, përmes kësaj gjykate, deri të Gjykata e Apelit në Shkup.

Deri te: **I dënuari N.D**

PTHP Shkup. KO.1611/04

Mbrojtësi M.I

Pas plotfuqishmërisë së aktvendimit:

Te departamenti për ekzekutimin e sanksioneve të kësaj gjykate⁸²

Analizimi i lëndës- duke analizuar rastin konkret që është paraqitur më lartë, kuptojmë se kemi të bëjmë me përdorimin e mjetit të jashtëzakonshëm juridik si kërkesa për Përsëritje të Procedurës Penale, këtë kërkesë e ka paraqitur i dënuari në mungesë. Dukë shfrytëzuar dispozitat ligjore që i lejojnë që të kërkojë përsëritje të procedurës penale, i dënuari e ka shfrytëzuar këtë mjet juridik. Ashtu siç e pamë i dënuari në mungesë ka kuptuar për aktgjykimin me të cilin është dënuar me burgim prej 5 vjetëve, shumë kohë më vonë se sa është marrë aktgjykimi, dhe ai brenda afatit prej 1 viti pasi ka kuptuar për aktgjykimin ka paraqitur këtë kërkesë. Kolegji penal pranë gjykatës ka vendosur në favor të tij, duke e pranuar kërkesën, dhe lënda shkon në rigjykim. Në bazë të aktvendimit të kolegjit janë zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së, që i sigurojnë këtë të drejtë të dënuarit në mungesë. Neni 465 i LPP-së parasheh si bazë apo arsye që i dënuari të kërkojë përsëritjen e procedurës penale në rastet kur i është shqiptuar dënim në mungesë dhe se nuk ka qenë i kapshëm për organet e drejtësisë.

⁸² Ky rast është marrë nga web faqja ku publikohen vendimet e të gjitha gjykatave në RM, www.sud.mk

5.5. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

Më poshtë do të paraqes kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si dhe pas saj edhe vendimin e Gjykatës Supreme të RM-së, në lidhje me këtë kërkesë.

PROKURORIA PUBLIKE

KOZ.46.2017

Nëpërmjet: Gjykatës Themelore Tetovë

04.09.2017

Deri te: Gjykata Supreme e RM-së

KËRKESË PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË

Kundër : Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Tetovë K.560/16 të datës 26.10.2016

Aktgjykimit të gjykatës së Apelit në Gostivar KZH.322/16 të datës 01.12.2016

Për shkak të: Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe

PROPOZOJ

Të aprovohet kërkesa si e bazuar në bazë të nenit 461 të LPP-së, si dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore Tetovë me nr K.560-16 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Gostivar me nr KZH.322/16 të shfuqizohen dhe lënda të kthehet në shkallë të parë për vendim dhe gjykim të ri.

ARSYETIM

Në bazë të aktgjykimit të Gjyktaës themelore Tetovë, i pandehuri J.F për veprën penale **MUNDËSIM I PËRDORIMIT TË DROGAVE NARKOTIKE në bazë të nenit 216 të Kodit Penal** e shpalli të fajshëm dhe i shqiptoi masën alternative DËNIM ME KUSHT, me çka i shqiptoj dënim me burgim prej 9 muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në kohëzgjatje prej 2 vitesh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nuk kryen vepër të re penale.

Gjykata e Apelit në Gostivar e pranoi ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, dhe vetëm në pjesën në të cilën parashihet sanksioni penal e ndryshoi aktgjykimin, dhe nga DËNIM ME KUSHT në kohëzgjatje prej 9 muajsh, i shqiptoi dënim me burgim efektiv prej 9 muajsh.

Në pjesën tjetër aktgjykimi u vërtetua.

Prokurori publik i RM-së vlerëson së në aktgjykimet edhe në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë ka shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së, të nenit 415 paragrafi 2, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit Penal të nenit 416, pika 5 të LPP-së, të nenit 408, pika 6 të LPP-së, dhe për shkak të shkeljes së nenit 40, paragrafi 1 të Kodit Penal dhe nenit 49, paragrafi 1.

PROKURORI PUBLIK

B.B

Në vijim do të paraqes vendimin e **Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë** në lidhje me **KËRKESËN PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË.**

KZZ.27/2017

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, në kolegji i përbërë prej Kryetarit të Gjykatës J.V- Kryetar i kolegjit dhe gjykatësit: R.K, XH.S, SH.D, A.F, anëtarë të kolegjit dhe procesmbajtësin S.S, duke vendosur për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e ngritur nga Prokurori Publik i RM-së me nr KOZ.45/2017, të datës 04.09.2017, kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore Tetovë me nr K.560/16 të datës 26.10.2016 dhe kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit në Gostivar KZH.322/16 të datës 01.12.2016, në prezencë të Prokurorit publik në Prokurorinë Publike të RM-së B.B, në seancën e mbajtur me datë 20.02.2018, në pnazë të nenit 460, paragrafi 1 i LPP-së, e solli këtë:

AKTVENDIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori publik në Prokurorinë publike të RM-së me nr KOZ.45/2017, të datës 04.09.2017, kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore Tetovë me nr K.560/16 të datës 26.10.2016 dhe kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit në Gostivar KZH.322/16 të datës 01.12.2016, **E HEDH POSHTË.**

ARSYETIM

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Tetovë K.560/16 të datës 26.10.2016 i pandehuri J.F për veprën penale **MUNDËSIM I PËRDORIMIT TË DROGAVE NARKOTIKE në bazë të nenit 216, paragrafi 1 të Kodit Penal** e shpalli të fajshëm dhe i shqiptoi masën alternative **DËNIM ME KUSHT**, me çka i shqiptoj dënim me burgim prej 9 muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në

kohëzgjatje prej 2 vitesh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nuk kryen veprë të re penale. I pandehuri është i detyruar që të paguaj shpenzimet paushalle prej 2.000,00 denarësh, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Gostivar KZH.322/16 të datës 01.12.2016, ankesa e PTHP Tetovë është pranuar dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore Tetovë është ndryshuar në pjesën e sanskionit penal, ashtu që i pandehuri J.F i cili me aktgjykimin e shkallës së parë është shpallur i fajshëm për veprën penale **MUNDËSIM I PËRDORIMIT TË DROGAVE NARKOTIKE në bazë të nenit 216, paragrafi 1 të Kodit Penal**, është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej muajsh. Pjesa tjetër e aktgjykimit është vërtetuar.

Prokurori publik i RM-së në bazë të nenit 39, paragrafi 2 dhe nenit 457 të LPP-së, deri të Gjykata Supreme e RM-së paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë KOZ.46/2017, kundër aktgjykimit të gjykatës Themelore K.560/16 dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gostivar KZH.322/16 për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të të procedurës penale, të nenit 415 paragrafi 2, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit Penal të nenit 416, pika 5 të LPP-së, të nenit 408, pika 6 të LPP-së, dhe për shkak të shkeljes së nenit 40, paragrafi 1 të Kodit Penal dhe nenit 49, paragrafi 1, me propozim që kërkesa të pranohet, aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë të shfuqizohen dhe lënda të kthehet në shkallë të parë për gjykim dhe vendim.

Gjykata Supreme e RM-së mbajti seancë të kolegjit dhe në prezencë të Prokurorit publik të Prokurorisë publike të RM-së, B.B, i cili në seancë të kolegjit e tërhoqi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, me çka kjo gjykatë vendosi:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë hedhet poshtë.

Në bazë të nenit 460 paragrafi 1 të LPP-së, nëse Prokurori publik e tërheq kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, gjykata me aktvendim do ta hedh poshtë kërkesën.

Duke pasur parasysh faktin se Prokurori publik i RM-së, në seancën e kolegjit para Gjykatës Supreme të RM-së e tërhoqi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, vijoi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të hedhet poshtë, në pajtim me nenin 460 paragrafi 1 i LPP-së.

Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, me datë 20.02.2018, me numër KZZ.27/2017.⁸³

Procesmbajtës

Kryetar i Gjykatës- gjykatës

S.S

J.V

⁸³ Ky rast është marrë nga Gjykata Themelore Tetovë

Analizimi i lëndës- më sipër pamë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në praktik, se si bëhet kjo kërkesë nga ana e Prokurorit publik dhe më pas vendimin e Gjykatës Supreme të RM-së. në bazë të LPP të RM-së kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqet vetëm prokurori publik, për dallim nga procedura penale e Kosovës që këtë kërkesë mundeshte ta paraqes edhe i pandehuri.

Në rastin konkret shohim se prokuroria nëjherr ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë, për shkak se në aktgjykimin e shkallës së parë, i pandehuri J.F, është dënuar më DËNIM ME KUSHT ME 9 MUAJ BURGIM, që domethënë se ai dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në kohëzgjatje prej 2 vjetësh, në të drejtën penale kjo kohë quhet koha e kontrollit. Neni 216 paragrafi 1 i Kodit Penal thotë: ***Ai që shtinë tjetrin që të posedojë droga narkotike dhe substanca psikotrope apo i jep droga narkotike që t'i posedojë ai apo person tjetër apo do të lë në dispozicion hapësira për t'i poseduar drogat narkotike dhe substancat psikotrope, apo në mënyrë tjetër i mundëson tjetrit që të posedojë droga narkotike dhe substance psikotrope, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.*** Duke pasur parasysh këtë nen të Kodit Penal, shohim se vepra penale për të cilën akuzohet J.F parasheh dënim me burgim prej 1 deri në 5 vjet, që domethënë se dënimi i cili i është shqiptuar është shumë i butë në krahasim më atë që e përcakton Kodi Penal mënyrë shumë të saktë dhe decide. Dhë për këtë arsye është paraqitur ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Nuk është kontestuar vërtetimi i gjendjes faktike, por është ankimuar vetëm pjesa e aktgjykimit e cila ka të bëjë më shqiptimin e sanksionit penal.

Gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e marrë e pranoi ankesën e PTHP Tetovë dhe e ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë vetëm në pjesën e sanksionit penal, dhe nga dënim me kusht shqiptoi dënim më burgim efektiv në kohëzgjatje prej 9 muajsh. Pjesa tjetër e aktgjykimit të shkallës së parë nuk u ndryshua, sepse pjesa tjetër nuk ishte kontestuese për PTHP.

Por Prokuroria pastaj përdori mjetin e jashtëzakonshëm juridik siç është **Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë**, prokuroria pretendonte se ka shkelje esenciale të dispozitivave të procedurës penale, që paraqesin bazë apo arsye që procedura penale të përsëritet dhe lënda të kthehet në shkallë të parë. Si pika në të cilat mbështetet kjo kërkesë janë neni 415 paragrafi 2 i LPP, që thotë se në seancë kryesore ka marrë pjesë gjykatës ose gjykatësi porot i cili patjetër është dashur të përjashtohet, neni 416 pika 5, që thotë se me vendimin për dënim, për dënim me kusht ose vërejtje gjyqësore është tejkaluar autorizimi që e posedon gjykata sipas ligjit, nenit 408 paragrafi 6 i LPP, që thotë se gjykata në arsyetimin e aktgjykimit duhet t'i nxjerrë shkaqet për çdo pikë të aktgjykimit, si dhe nenin 40 paragrafi 1 dhe nenin 59 paragrafi 1 të Kodit Penal. Por gjatë mbajtjes së seancës në kolegjin e Gjykatës Supreme, Prokurori publik i Prokurorisë Publike, e ka tërhequr kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila i jep të drejtë Gjykatës Supreme që këtë kërkesë me aktvendim ta hedh poshtë. Shkaqet e tërheqjes së kësaj kërkesë nga ana e Prokurorit nuk i dijmë as ne që e pamë vendimin e Gjykatës Supreme.

5.6.Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm

Më poshtë do të sjellim Kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm, pas saj do të sjellim edhe vendimin e Gjykatës Supreme të RM-së.

K.555/04

Nëpërmjet: Gjykatës Themelore Tetovë

Deri te: Gjykata Supreme e RM-së

KËRKESE PËR RISHQYRTIM TË JASHTËZAKONSHËM TË AKTGJYKIMIT TË PLOTËFUQISHËM

Nga i gjykuari A.K prej fshatit J...., nëpërmjet mbrojtësit S.T nga Tetova.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Tetovë me numër K.555/04, të datës 31.01.2005, e vërtetuar me aktgjykim të Gjykatës së Apelit Shkup KZH.2386/05, të datës 26.12.2005, i gjykuari është shpallur fajtor për veprat penale Grabitje, neni 237 paragrafi 3 i KP, Grabitje, neni 237 paragrafi 1 në lidhje me nenin 22 i KP dhe për 6 vepra penale Vjedhje e rëndë, neni 236 paragrafi 1 i KP, dhe i dënuar me dënim me burg pre 8 vjetësh.

I gjykuari A.K nëpërmjet mbrojtësit të tij, pas marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paraqiti Kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm për shkak të cënimit të Kodit penal në dëm të të dënuarit.

Gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë gjatë vendosjes në lidhje me këtë lëndë, nuk kanë marrë asnjë veprim me të cilin do të vërtetonte se në çfarë gjendje psikofizike ka qenë i dënuari, në çfarë rethanash i ka kryer veprat penale, a ka mundur ta kuptojë rëndësinë e veprave të veta, dhe e gjithë kjo si fakt që i dënuari është i varur nga droga.

Është e papranueshme se për personalitet të tillë nuk ka analizë nga njëri prej të përgatitur Ekspert në përbërje të neuropsikijatërit, piskologut dhe puntorit social.

Në procedurën paraprake i dënuari ka pranuar se i ka kryer veprat penale, gjithashtu ka sqaruar edhe motivet për të cilat e ka kryer, ai ka qenë i varur nga droga dhe gjatë krizave që ka pasur ka ardhur deri te kryerja e veprave penale.

Edhe pse në ankesën që është paraqitur në shkallë të dytë, mbrojtësi i A.K, ka paraqitur provë të shkruar nga Sitali Neuro-Psikijatrik Shkup me nr 07-289/2, në të cilin shënohet se A.K në periudhën prej 27.06.2002 deri më 15.08.2002 ka qenë i trajtuar në këtë spital me diagnozën varësi nga narkotikët, kjo provë nuk është marrë parasysh.

Në këtë mënyrë gjykata e shkallës së parë i ka cënuar dispozitat e nenit 382 paragrafi 2 të LPP-së sepse nuk i ka marrë parasysh provat që e përjashtojnë përgjegjësinë penale, në bazë të shkaqeve të lartëpërmendura:

PROPOZOJ

Deri te Gjkata Suprem e RM-së, ta PRANOJË këtë kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjytimeve të plotëfuqishme me nr K.555/04 dhe KZH.2386/05 dhe lëndën ta kthejë për rigjykim në shkallë të parë.

Mbrojtësi i të dënuarit

S.T

Më poshtë do të sjellim vendimin e Gjykatës Supreme në lidhje me kërkesën e lartëshënuar, vendimin do e paraqesim në pika sa më të shkurta.

KVP.152/2006

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, GJYKATA SUPREME R REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, në kolegji e përbërë prej gjykatësve: A.M- kryetar i kolegjit, N.KM, M.K, me procesmbajtës O.G, duke vendosur për kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm të Gjykatës Themelore Tetovë me nr K.555/04 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Shkup me nr KZH.2386/05 e paraqitur nëprmet mbrojtësit të tij S.T, në seancën e mbajtur me datë 21.06.2006, e solli këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm të Gjykatës Themelore Tetovë me nr K.555/04 dhe Gjykatës së Apelit Shkup me nr KZH.2386/05, **REFUZOHET SI E PABAZË**

ARSYETIM

Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkallës së dytë, i dënuari A.K ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm, për shkak të cënimit të nenit 382 pika 2 e LPP-së. Me propozimin që kërkesa të pranohet, aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë të shfuqizohen dhe lënda të kthehet në shkallë të parë.

Pasi Gjykata Supreme e RM-së, i analizoi të gjitha faktet dhe provat e paraqitura, vendosi që:

Kërkesa është e pabazë

Në bazë të shkaqeve që janë paraqitur nga ana e mbrojtësit, duke i arsyetuar veprimet e të dënuarit A.K se ka qenë i ndikuar na substancat narkotike dhe ka qenë i varur dhe në kohë krizash. Këto pretendime të mbrojtësit nuk janë të argumentuara dhe janë paushall, me qëllim të vetëm që t'i ndihmohet kryerësit të veprave penale.

Vendosur në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë me datë 21.06.2006.

Kryetar i kolegjit- gjykatës

A.M

Analizimi i lëndës- në këtë lëndë kemi përdorimin e mjetit të jashtëzakonshëm juridik siç është **Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjyimit të plotëfuqishëm**, ashtu si e pamë edhe më lartë, i akuzuari A.K ishte i dënuar për disa vepra penale, pas marjes së vendimit në shkallë të parë, mbrojtësi i tij kishte paraqitur ankesën kundër aktgjyimit të shkallës së parë, gjykata e shkallës së dytë vetëm e kishte vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë në të gjitha pjesët e tij. Mbrojtja nuk kishte paraqitur fakte dhe prova bindëse për gjykatën të cilat do të çonin në atë që të pranohet kërkesa e tyre dhe lënda të kthehet për rigjykim në shkallë të parë. Nuk mundeshte të arsyetohen ato 8 vepra penale, 2 grabitje dhe 6 vjedhje të rënda me arsyetimin se kryerësi nuk ka qenë i vetëdisjdhëm për veprimet e tij, sepse ka qenë i varur nga droga. Dhe kjo ka sjellë në atë që gjykata e shkallës së dytë të mos merr parasysh këto pretendime të mbrojtjes

Pas kësaj mbrojtja paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm deri të Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, kjo gjykatë gjatë vendosjes në lidhje me këtë kërkesë e shpalli atë si të PABAZË, duke e arsyetuar se pretendimet e mbrojtjes janë të pa argumentuara mirë dhe se nuk ka shkelje procedurale ashtu siç pretendon mbrojtja, por i vetmi qëllim kryesor është që të ndihmohet kryerësi i veprave penale dhe me rigjykim në shkallë të parë të marrë ndonjë dënim më të butë në krahasim me dënimin prej 8 vjetësh burgim që i kishte shqiptuar gjykata e shkallës së parë dhe të cilin e kishte vërtetuar gjykata e shkallës së dytë.⁸⁴

⁸⁴ Ky rast është marrë nga Gjykata Themelore Tetovë

PËRFUNDIME

Si përfundim do të mund të konstatojmë se Republika e Maqedonisë, në vitet e fundit ka pasur një kolaps total të sistemit gjyqësor ku është përballur me kritika të ashpëra nga ana Komisionit Evropian si dhe ndërkombëtarët, vitet e fundit kemi pasur sistem gjyqësor të kapur dhe të politizuar dhe ku janë shkelur standardet dhe parimet bazë të së drejtës penale si dhe shkelje të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Viteve të fundit gjykatat e shkallëve më të larta nuk e bënin në përpikmëri detyrën që e kanë të përcaktuar me ligj, që domethënë të jenë korrigjues të vendimeve të gjykatave në shkallë më të ulët, por ata vetëm vërtetonin aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë, pra nuk ishin korrigjues të atyre vendimeve jo të ligjshme, por u vunë në shërbim të politikës dhe merrnin vendime të cilat vetëm se më diheshin ende pa u shpallur aktgjykimi.

Mjetet juridike janë ato që duhet të sigurojnë pacënueshmërinë e të drejtave të çdo qytetari, pacënueshmërinë e dinjitetit të çdo qytetari, që domethënë se pushteti gjyqësor duhet të jetë garantuesi i lirive dhe të drejtave të çdo qytetari, të gjithë duhet të jenë të barabart para ligjit, pa asnjë dallim. Pa dyshim se shfrytëzimi i mjeteve juridike në procedurë penale ndihmon që ato vendime gjyqësore që janë marrë në mënyrë jo të rregullt, duhet të kthehen dhe të rishikohen, dhe që në fund të arrihet një vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Si kushte të cilat janë vendosur nga ana e Komisionit Evropian janë: depolitizimi i gjykatave, këtu ceket se kjo duhet të ndodhë në praktikë dhe jo vetëm në letër, zhvillimin e reformave që kanë të bëjnë me pushtetin gjyqësor në një linjë me BE-në dhe dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias, zhvillimi i sistemit gjyqësor duke pasur një strategji konkrete e cila do të kthente besimin e qytetarëve te gjykatat. Si vërrejtje tjera që janë përmendur janë presionet që ju bëhen gjykatësve nga ana e ekzekutivit dhe ndikimi politik në përzgjedhjen e tyre.

Në raportin e vitit 2018 përmendet se vendi ka progress në disa sfera të sistemit gjyqësor, vendi inkurajohet që të vazhdojë me reformat në gjyqësor duke pasur për bazë rekomandimet e BE-së dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias, aty përmendet se duhet të largohet çdo lloj ndikimi politik te Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve të RM-së. Shpresojmë se në një të ardhme të afërt edhe ne do të kemi një sistem të pavarur gjyqësor, jo vetëm në aspektin “formal” por edhe atë “real”.

Literaturë e shfytëzuar

- Sahiti.E, Zejneli.I, E drejta e procedurës penale, Shkup, 2017
- Islami.H, Hoxha.A, Panda.I, Procedura Penale, Tiranë, 2003
- Kristijan Shreder.F, E drejta e procedurës penale,Alamina, Shkup, 2010
- ФОЛК КЛАУС, „КАЗНЕНО ПРОЦЕСНО ПРАВО – ОСНОВЕН КУРС“, АЛАМИНА, СКОПЈЕ, 2013.
- Г. Бужаровска, Г. Калајџиев, Б. Мисоски, Д. Илиќ-Димоски, Казнено процесно право (учебно помагало), Скопје, 2015 г.
- БОЛКЕ ВЕРНЕР, „ЗАКОН ЗА КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА“, ДАТАПОНС, СКОПЈЕ, 2009
- МАТОВСКИ, Н. „КАЗНЕНО ПРОЦЕСНО ПРАВО – ОПШТ ДЕЛ“, ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ „ЈУСТИНИЈАН ПРВИ“, СКОПЈЕ И ВТОРИ АВГУСТ – С ШТИП, СКОПЈЕ, 2003
- Kambovski.V, E drejta penale- Pjesa e përgjithshme, Shkup, 2010
- Shegani.A, E drejta penale e krahasuar, Tiranë, 2002
- МАТОВСКИ, Н./ БУЖАРОВСКА, Г. /КАЛАЈЏИЕВ, Г., „КАЗНЕНО ПРОЦЕСНО ПРАВО“, ВТОРО ИЗМЕНЕТО И ДОПОЛНЕТО ИЗДАНИЕ, ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ „ЈУСТИНИЈАН ПРВИ“-СКОПЈЕ, СКОПЈЕ 2011
- Матовски, Никола. Лажетиќ-Бужаровска, Гордана. Калајџиев, Гордан. Казнено Процесно Право, Скопје,2011
- Marjanoviç,GJ, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Shkup, 2003
- МАТОВСКИ, Н. „КАЗНЕНО ПРОЦЕСНО ПРАВО – ПОСЕБЕН ДЕЛ“,ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ „ЈУСТИНИЈАН ПРВИ“, СКОПЈЕ, СКОПЈЕ, 2004
- КРАПАЦ, Д. „КАЗНЕНО ПРОЦЕСНО ПРАВО“, НАРОДНЕ НОВИНЕ, ЗАГРЕБ, 2003 ГОД.
- Elezi.N, Reformat e procedures penale në Ballkanin Perëndimor.,Shkup, 2013
- Hajdari A., E drejta e procedurës penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë,2015.
- Sahiti E. dhe Murati R., E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2014
- Sahiti, E, Murati, R, Elshani, Xh, Komentari i Kodit të procedurës penale, Prishtinë, 2014.
- Bayer, Vladimir, Kazнено процесно pravoodabrana poglavlja. Knjiga I. Uvod u teoriju krivičnog procesnog prava, përgaditi, Davor Krapac Zagreb, 1995.
- Sahiti, Ejup, Argumentimi në procedurën penale, Prishtinë, 2006.
- Sahiti Ejup, Murati Rexhep, Kunštek Eduard,“Criminal Procedure System of Kosovo”, ed.Berislav Pavišić,: “Transition of Criminal Procedure Systems”, Rijeka, 2004., fq. 125-145

- Bayer, Vladimir, Kazнено procesno pravo odabrana poglavlja. Knjiga II, Povijesni razvoj kaznenog procesnog prava, përgatiti: Davor Krapac, Zagreb, 1995
- Hajdari. A, Komentar- Kodi i procedurës penale, Prishtinë, 2016
- Hajdari A. E drejta e procedurës penale- Komentar, Prishtinë, 2010
- Sierčić Č. Krivično procesno pravo, Sarajevo, 2005
- Stevanović Č i dru. Krivično posebno pravo, Beograd, 1997,
- Samaha.J, Criminal procedure, Boston, 2014
- Rolando V. Criminal Procedure: Law and Practice, New York, 2016,
- Swanson Ch. Criminal Investigation, London, 2014
- Fausto I. E drejta procedurale penale, Përkthim, Tiranë, 2002.Grigor Gj. Procedura penale e RPSH, Pjesa e posaçme, Tiranë, 1970,
- Grubač M. Krivično procesno pravo, Posebni deo, Beograd, 2004
- Jekić, Z, Krivično procesno pravo, botimi i shtatë, Beograd, 2001
- Pavišić, Berislav, Komentar Zakona o kaznenom postupku, Šmrka, 2015.
- Pavišić, Berislav, Karakteristikat themelore të trazicionit të procedurave penale, E drejta, Prishtinë, 2004., nr. 4.
- Dressler, Joshua, Understanding Criminal Procedure, NeëYork (USA) and Oakland (CA),1991

Tekstet Ligjore

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë
- Kodi Penal i RM-se, "Gazeta Zyrtare e Rm-së"; nr. 37/96 dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij në numrat vijues të Gazetës zyrtare: 80/99; 48/01; 4/02; 16/02; 43/02; 19/04; 40/04; 81/05; 50/06; 60/06; 72/06; 7/08; 139/08; 114/09; 51/11; 135.11; 195/2011; 142/2012; 166/2012 dhe 55/2013
- Ligji i procedurës penale i Republikës së Maqedonise, "Gzaeta zyrtare e RM-së", nr. 15/97; 18/99; 44/02; 27/04; 74/04; 15/05; 75/06; 83/03; 53/09; 67/09; 150/2010; 51/2011; 100/2012.
- Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale i RM-së, Gazeta Zyrtare., nr. 2/2006.
- Ligji për gjykatat (Gazeta zyrtare e RM nr.58/06)
- Ligji për prokurorinë publike (Gazeta zyrtare e RM nr.150/07)
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, nr.04/L-123
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2013
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Sërbisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sërbisë, nr 72/2011 dhe 101/2011
- Kodi i Procedurës Penale i Kroacisë, Gazeta Zyrtare, nr. 62/2003

Rastet Konkrete

- Lëndët penale të marra nga Gjykata Themelore e Tetovës
- Lëndët e mara nga portali i gjykatave të RM-së www.sud.mk , në pjesën ODLUKI NA SUDOV

Linqet

- www.sud.mk
- https://en.wikipedia.org/wiki/Legal_remedy
- <https://www.scribd.com/doc/294258847/Mjetet-e-rregullta-dhe-te-jashtezakonshme-juridike-ppt>
- <https://www.slideshare.net/NasufGrmizaj/e-drejta-e-procedures-penale>
- <http://kvadraturanakrugot.crnaovca.mk/2016/12/14/zhalba-na-reshenieto-na-osnovnoto-javno-obvinitelstvo-za-odbivanje-na-krivichnata-prijava-protiv-dik/>
- www.akademik.mk
- www.pravdiko.mk
- www.sudstvo.mk